

Rritja e rolit të Parlamentit në procesin e integritit përmes pjesëmarrjes legislative dhe transparencës

Buletin informativ Nr.3

Qershor 2012

Vlerësimi i përputhshmërisë së ligjeve me *acquis* e BE-së dhe roli i Kuvendit në këtë proces

1. Hyrje

Ky punim synon të japë një vlerësim të përgjithshëm për mënyrën sesi realizohet procesi i kontrollit të përafritit të ligjeve në kuadër të procesit të integritit europian, duke u përqëndruar vecanërisht tek roli i Kuvendit në këtë proces. Punimi është i ndarë në dy pjesë, pjesa e parë do të bëjë një përshkrim të shkurtër të kërkesave ligjore për procesin e kontrollit të përafritit të ligjeve dhe përgjegjësitë që kanë institucionet e përfshira në ligjvënje. Pjesa e dytë do të ndalet tek disa ligje konkrete të cilat në kemi analizuar në mënyrë që të nxjerrim në pah respektimin formal të detyrimit ligjor për procesin e përafritit. Duke qenë se fokusi ynë është roli i Kuvendit në këtë proces, në jemi ndalur pikërisht të fazën finale e kontrollit e cila realizohet nga strukturat parlamentare. Për të bërë analizën e ligjeve të përzgjedhura ne jemi mbështetur në kuadrin ligjor ekzistues që përfshin Rregulloren e Këshillit të Ministrave, Rregulloren e Parlamentit të

cilat përmbajnë detyrimet për çdo institucion, si edhe tek dokumentat e depozituara në Kuvendin e shqipërisë së bashku me projektet e ligjeve.

Dokumentat e mara në shqyrtim për projektligjet objekt i kësaj analize, janë tekstet e miratuara të ligjeve, pra ashtu sikurse janë botuar në fletoren zyrtare, relacionet shoqëruese, tabelat e përpueshmërisë dhe raportet e komisioneve parlamentare, (raporti i Komisionit përgjegjës dhe Komisioni i Integritit). Ligjet që do të merren në analizë janë përzgjedhur nga lista e ligjeve të miratuara gjatë vitit 2011 dhe ato rregullojnë fusha të ndryshme të cilat preken nga procesi i përafritit. Pesë ligjet e përzgjedhura janë:

1. Ligji nr. 10 480 datë 17.11.2011 Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore

2. Ligji nr. 10489 datë 15.12.2011 Për Tregtimin dhe Mbikqyrjen e Tregut të Produkteve jo ushqimore

3. Ligji Nr. 10 463, date

(vijon në faqen 2)

Në këtë numër:

1. Vlerësimi i përputhshmërisë së ligjeve me *acquis* e BE-së dhe roli i Kuvendit në këtë proces

Erion Fejzulla

Aida Gugu

faqe1-8

2. Zhvillimet Kushtetuese të Traktatit të Lisbonës në fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë në nivel mbikombëtar dhe kombëtar

Alfred Kellerman

faqe9-14

3. Raport mbi veprimtarinë e Komisionit Parlamentar për Integritin Europian dhe punimeve të Kuvendit në seancë plenare Mars –Maj 2012

Denis Gila

faqe15-18

4. Debati intelektual mbi Deficitin Demokratik në Bashkimin Europian

Dr. Dorian Jano

faqe18-22

5. Kalendari i punimeve të Kuvendit

(11 qershor – 28 qershor 2012)

faqe23-25

KALENDARI I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(11 qershor – 28 qershor 2012)

❖ Veprimtari në Komisionet e Përhershme të Kuvendit.

1. Projektligj “Për transmetimet me zë dhe/ose me zë e figurë në Republikën e Shqipërisë”.

(vijon në faqen 42)

Mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Soros.
Mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Vlerësimi i përputhshmërisë së ligjeve me *acquis* e BE-së dhe roli i Kuvendit në këtë proces

(vijon nga faqja 1)

22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”

4. Ligji Nr. 10 385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

5. Ligji Nr. 10 385, datë 24.02.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”

2. Kuadri institucional dhe ligjor për kontrollin e procesit të përafrimit të ligjeve

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së është një nga detyrimet themelore të procesit të integritimit evropian të Shqipërisë. Ky proces ka nisur në fillim të viteve 90 në kohën kur Shqipëria në kuadër të Marrëveshjes Ekonomike dhe Tregtare me Komunitetin Evropian¹ kishte marrë përsipër të harmonizonte legjislacionin në fushën ekonomike me atë të BE-së. Megjithatë ngritja e strukturave të specializuara dhe përsirja e procedurave konkrete për të realizuar procesin e përafrimit daton në vitin 2003 kohë në të cilën Shqipëria u përfshi në Procesin e Stabilizimit Asocimit. Prosesi i përafrimit është një proces kompleks dhe i vështirë.

Evolucionin institucional dhe procedural ligjor për të realizuar procesin e përafrimit mund ta përmbledhim si më poshtë:

1. Krijimi i Drejtorisë së përafrimit të legjislacionit²,
2. Krijimi i Ministrisë së Integritimit evropian³,
3. Krijimi i Komitetit për Koordinimin ndër-institucional të integritetit⁴,
4. Krijimi i grupeve ndër-institucionale të punës⁵,
5. Krijimi i strukturës së posacme në Kuvendin e Shqipërisë (Njësia e përafrimit të legjislacionit)⁶.

Strukturat e lartpërmendura kanë detyrimin për të koordinuar, realizuar dhe certifikuar përafrimin me *acquis* e BE në faza të të ndryshme hartimit të ligjit.

Rregullat për procesin ligjvënës në Shqipëri bazohen kryesisht në Rregulloren e Këshillit të Ministrave të miratuar me VKM nr. 584 datë 28. 3. 2008 e ndryshuar dhe Rregulloren e Kuvendit të miratuar me Vendimin 166, datë 16.12.2004 e ndryshuar. Rregulloret janë ndryshuar ndër të tjera edhe për të akomoduar disa nga procedurat e domosdoshme për procesin e përafrimit të legjislacionit.

Në bazë të Rregullores së Këshillit të Ministrave dhe ndryshimeve të pësuara në vite, detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar me atë të BE bie si fillim tek Ministria apo institucioni propozues i aktit ligjor⁷. Ministria përgjegjëse në bazë të prioriteve të përcaktuara, bën vlerësimin e parë të detyrimit për të përafruar legjislacionin. Ndërkohë që nga 2009, vlerësimi më i plotë i detyrimit për të përafruar legjislacionin realizohet nga Grupet ndër-institucionale të punës⁸. Grupet ndër-institucionale të punës janë ndarë sipas kapitujve të *acquis* së BE-së dhe ato luajnë një rol të rëndësishëm për sa i përket analizimit të nevojave për përafrimin dhe koordinimin ndër-institucional për marrjen e nismave ligjore nga një institucion i caktuar apo edhe për marrjen e nismave të përbashkëta. Institucioni përgjegjës

është i detyruar të bëjë analizën krahasuese midis legjislacionit të BE që do të përafrohet dhe legjislacionit shqiptar që preket nga ky ligj i BE. Ministria përgjegjëse duhet të përgatisë përveç relacionit shpjegues dhe tabelat e përpueshmërisë përmbajtja e të cilave është shpjeguar në Instrumentat e përafrimit në Rregulloren e Këshillit të Ministrave⁹.

Për të përcaktuar saktë prioritetet dhe për të përcaktuar shkallën e përafrimit, Ministria përgjegjëse duhet të bëjë vlerësimin e efekteve rregullatore të ligjit. Ky vlerësim kërkon kryerjen e analizave paraprake të një sërë faktorëve si: deri ku mund të shkojë rregullimi ligjor, cilat janë efektet që ai pritet të sjellë, sa janë mundësitë e zbatimit të plotë të tij, si do të jetë reagimi i qytetarëve, bizneseve etj, çfarë kostosh kërkon zbatimin e tij, a do të sjellë ligji të ardhura në buxhetin e shtetit, a do të ketë shpenzime, a është e nevojshme ngritja e institucioneve të tjera për zbatimin e tij, etj. Kjo analizë ndihmon në të përcaktuarit nëse përafrimi i një akti të *acquis* së BE-së në një moment të caktuar është një zgjidhje e mire ose jo, nëse është e mundur të kryhet përafrimi i plotë apo i pjesshëm dhe se kur mund të kryhet përafrimi i plotë si dhe nëse përafrimi duhet të bëhet me ligj apo me ndonjë akt tjetër nënligjor. Rregullorja e Këshillit të Ministrave parashikon detyrimin për kryerjen e këtij vlerësimi, edhe pse jo shumë të hollësishëm. Projektligji i përafruar nga Ministria përgjegjëse dhe dokumentat e tij shoqëruar kalojnë në filtra kontrollit.

Vlerësimi dhe kontrolli i parë i përputhshmërisë bëhet nga Ministria e Integritimit Evropian. Ministria e Integritimit bën vlerësimin e përputhshmërisë së projekt aktit duke vlerësuar raportin e përafrimit (relacionin) dhe tabelave të përputhshmërisë. Mos plotësimi i duhur i relacionit dhe tabelave të përputhshmërisë i jep të drejtën MoEI ta kthejë tek Ministria propozues ligjin deri në plotësimin e kërkesave. MoEI bën dhe certifikimin e përputhshmërisë me *acquis* e BE-së¹⁰. Vlerësimi i MoEI për sa i përket përputhshmërisë miratohet i pakontestuar në Këshillin e Ministrave.

Vlerësimi dhe kontrolli i dytë i përputhshmërisë dhe detyrimeve të instrumentave të përafrimit bëhet në Kuvendin e Shqipërisë përpara se projektligji të miratohet në seancë plenare. Sipas Rregullores së Kuvendit cdo projektligj duhet të shoqërohet me tabelat e përputhshmërisë dhe relacionin përkatës, në të kundërt Kryetarja e Kuvendit ka të drejtë ta kthejë ligjin për të plotësuar këto kërkesa¹¹.

3. Rregullat specifike për përafrimin e legjislacionit sipas *Instrumentave të Përafrimit*

Sipas Instrumentave të përafrimit të parashikuara në Rregulloren e Këshillit të Ministrave projektligji duhet të shoqërohet nga Relacioni dhe Tabelat e Përputhshmërisë. Relacioni duhet të përmbajë ndër të tjera:

1. Emrat e institucioneve propozuese dhe atyre pjesëmarrëse në procesin e hartimit të projektligjit
2. Statusin e projektit

(vijon në faqen 3)

Vlerësimi i përputhshmërisë së ligjeve me *acquis* e BE-së dhe roli i Kuvendit në këtë proces

(vijon nga faqja 2)

3. Referimin tek nenet e MSA apo tek detyrime të tjera të përmbajtura në dokumentat e rëndësishëm të procesit si Partneriteti Europian, NPISAA.

4. Nivelin e përputhshmërisë dhe arsyet e zgjedhjes së këtij niveli.

5. Tabelat e përputhshmërisë

6. Përshkrimin e masave zbatuese

7. Konfirmimin nga Ministria e Integritimit¹²

Teblat e përputhshmërisë janë të ndara në disa kolona, ku në kolonën e parë duhet hedhur teksti i *acquis* që do të përafrohet, në kolonën e dytë nenet korresponduese të projektligjit shqiptar, në kolonën e tretë shkalla e përputhshmërisë, në kolonën e katërt arsyet e përzgjedhjes së shkallës së caktuar dhe në kolonën e pestë periudhën se kur parashikohet të arrihet përafrimi i plotë. Normalisht cdo Ministri duhet të plotësojë dy tabela. Njëra që ka si kolonë të parë ligjin e BE që do të përafrohet, ndërsa tabela e dytë duhet të ketë si kolonë të parë draft ligjin shqiptar që do të përafrojë ligjin europian. Kolonat e tjera mbeten të pandryshuara.

Rregullorja e Këshillit të Ministrave ka parashikuar gjithashtu që ligjet që përafrojnë legjislacionin e BE-së të japin informacion, nëpërmjet një shënimi në fund të faqes së parë mbi aktin e BE-së së përafruar duke paraqitur titullin e aktit, institucionin që e ka nxjerrë, numrin CELEX dhe të dhënat e Fletores Zyrtare ku është botuar akti¹³.

Mbetet përgjegjësi Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit zbatimi i kërkesave të renditura më sipër. Por si dhe sa monitorohen këto kërksa nga institucionet shqiptare dhe konkretisht nga Kuvendi i Shqiperisë mbetet për tu vlerësuar në vazhdimësi. Për të realizur këtë në kemi përzgjedhur 5 ligje të fushave të ndryshme të cilat përafrojnë legjislacionin e BE.

4. Analiza e ligjeve

I. Ligji nr. 10 480 datë 17.11.2011 Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore.

Institucioni propozues/përgjegjës: Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjisë

Përmbajtja e ligjit: Ligji mbi sigurinë e përgjithshme të produkteve jo ushqimore ka për qëllim mbrotjen e konsumatorëve dhe publikut në përgjithësi në lidhje me hedhjen në treg të produkteve të reja apo të përdorura apo produkteve të cilat përdoren gjatë ofrimit të shërbimit. Ky ligj përcakton detyrimin e operatorëve dhe strukturave përgjegjëse për të garantuar sigurinë e produkteve, si edhe parashikon sanksione administrative dhe deri vënien e gjobave për shkeljet që mund të kryejnë operatorët tregtarë.

Referenca në *acquis* e BE: Ky ligj është përafruar pjesërisht me direktivën nr. 2001/95/KE të Parlamentit dhe të Këshillit datë 3 dhjetor 2001 “Mbi sigurinë e përgjithshme të produkteve” Numri CELEX : 32001L0095 Fletorja zyrtare e BE seria L, nr. 177 datë 15.1.2002 faqe 4-17. Rregulloren nr. 765/2008/KE të parlamentit Europian dhe këshillit datë

9 korrik 2008 “Mbi vendosjen e kërkesave për akreditim dhe mbikqyrjen e tregut lidhur me tregtimin e produkteve” e cila shfuqizon rregulloren nr. 339/93/KEE. Numri CELEX 32008R0765. Fletorja zyrtare e Bashkimit Europian seria L, nr. 218 datë 13.8.2003 fq. 30-47. Referenca të marra nga vete ligjë në plotësim të pikës 21.1 të Rregullores së Këshillit të Ministrave.

Relacioni i ligjit: Relacioni i ligjit 10 480 përmbush disa prej kërkesave të parashikuara në instrumentat e përafrimit.

1. Ai përmban institucionin përgjegjës dhe hartues të ligjit

2. Jep detaje për statusin e ligjit

3. Bën një referim tek MSA

4. Nuk jep detaje për nivelin e përafrimit dhe as për arsyet e nivelit të përafrimit të zgjedhur

5. Përmban tabelën e përputhshmërisë

6. Nuk përmban masa zbatuese

7. Nuk përmban konfirmimin nga Ministria e Integritimit.

Tabela e përputhshmërisë: Projektligji është i shoqëruar nga tabela e përputhshmërisë në përputhje Instrumentat e përafrimit.

Komente të përgjithshme

Nga analizimi i dokumentave të sipërpërmendura na rezulton se ligji 10 480 plotëson kërkesat formale ligjore të procesit të përafrimit të legjislacionit. Komisioni i Integritimit ka kryer kontrollin formal të procesit duke e vendosur si një pikë në raportin e tij për këtë ligj¹⁴.

Ky ligj përafrohet pjesërisht dy ligje dytësore të Bashkimit Europian. Në raportin e Komisionit përgjegjës është relatuar se ky ligj është në përputhje të plotë me direktivat e BE. Ndërkohë që gjatë analizës që i është bërë nen për nen në Komisioni e Integritimit ka rezultuar që ky projektligj është përafruar në mënyrë të pjesshme me legjislacionin dytësor europian. Ky konstatim i Komisionit të Integritimit është i saktë pasi ashtu sikurse rezulton nga përmbajtja e ligjit në krahasim me tekstin e direktivës 2001/95 KE si edhe me Rregulloren 765/2008 ligji ka bërë ndryshime në përkufizime, si edhe nuk ka reflektuar plotësisht qëllimin dhe nenet e Rregullores 765/2008. Në këtë pikë duhe theksuar se përcaktimi i nivelit të përpueshmërisë së legjislacionit shqiptar me atë të BE është e drejtë e institucioneve shqiptare, të cilat në cdo rast duhet të motivojnë shkallën e përputhshmërisë, pra të japin arsye pse është zgjedhur përafrimi i pjesshëm përkundrejt përafrimit të plotë.

Mungesa e një analizë paraprake për kostot dhe përfitimet e ligjit e bën të vështirë vlerësimin nëse institucioni është gati të sigurojë përafrimin e plotë. Relacioni shoqëruar është i mangët në drejtim të paraqitjes së kësaj analize. Tabela e përpueshmërisë rezulton një formë e një drafti, pasi aty ka disa mangësi të vogla në formatim si edhe

(vijon në faqen 4)

Vlerësimi i përputhshmërisë së ligjeve me *acquis* e BE-së dhe roli i Kuvendit në këtë proces

(vijon nga faqja 3)

ndryshime në tekstin e ligjit shqiptar përkundrejt variantit të ligjit të miratuar dhe të botuar në fletoren zyrtare. Dispozitat e legjislacionit europian nuk janë hedhur të gjitha në kolonën e parë, ato janë referuar në mënyrë të shkëputur. Do të ishte mirë që legjislacioni I BE të reflektohet i gjithi në kolonë, pasi kjo do të ndihmonte vlerësimin më të plotë të përafrimit dhe do të jepte indikacione se kur mund të kryhet përafrimi i plotë. METE për këtë projektligj ka bashkëngjitur vetëm një tabelë.

II. Ligji nr. 10489 datë 15.12.2011 Për Tregtimin dhe Mbikqyrjen e Tregut të Produkteve Jo ushqimore Institucioni Propozues: Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjisë

Përmbajtja e ligjit: ligji parashikon rregullat e përgjithshme mbi tregtimin e produkteve, nëpërmjet ngritjes së një sistemi eficient të mbikqyrjes së tregut me qëllim garantimin e mbrojtjes së shëndetit sigurisë së konsumatorëve dhe interesave të tjerë publikë.

Referenca tek *acquis*: Ligji është I përafuar me Vendimin 768/2008 të Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 9 korrik 2008 “Mbi kuadrin e përbashkët për tregtimin e produkteve i cili shfuqizon vendimin e Këshillit 93/565/KEE”. Numri CELEX: 32008D0768, Fletorja Zyrtare e BE Seria L, nr. 218 datë 13.08.2008 fq. 82-128. Rregulloren 756/2008/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 9 korrik 2008 Mbi vendosjen e kërkesave për akreditimin dhe mbikqyrjen e tregut lidhur me tregtimin e produkteve e cila shfuqizon Rregulloren 339/93/KEE”. Numri CELEX 32008R0765 Fletorja Zyrtare e BE Seria L. nr 218 datë 13.08.2008 fq. 30-47.

Relacioni i ligjit përmbush pothuajse të gjitha kërkesat e parashikuara në Instrumentat e përafrimit:

1. Ai përmban institucionin përgjegjës
2. Jep detaje për statusin e ligjit
3. Bën referim tek MSA
4. Jep disa detaje për nivelin e përafrimit të përzgjedhur
5. Përmban tabelën e përputhshmërisë
6. Përman disa masa zbatuese
7. Nuk përmban konfirmimin nga Ministria e Integritimit

Tabela e përputhshmërisë: Ligji është I shoqëruar me tabelën e përputhshmërinë në përputhje me VKM 584.

Komente të përgjithshme:

Ky ligj i prozuar nga METE është një nga iniciativat e rëndësishme për përafrimin e legjislacionit horizontal në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Ai ashtu sikurse dhe ligji i mësipërm është bërë me asistencë të ekspertëve të huaj në kuadër të projektit CARDS 2006 Mbështetje për rregullat teknike, mbrotjen e konsumatorit dhe mbikqyrjen e tregut. Ligji plotëson kërkesat formale të procesit të përafrimit të legjislacionit pasi ai përmban referimin tek *acquis* dhe tabelat e përputhshmërisë.

Përsa i përket nivelit të përputhshmërisë, ky ligj është i përafuar plotësisht me vendimin 768/2008 dhe pjesërisht me rregulloren 765/2008. Ky nivel përputhshmërie është shpjeguar edhe në relacionin shoqëruar dhe është konfirmuar në Raportin e Komisionit të Integritimit Europian. Komisioni I integritimit ka bërë kontrollin formal të përputhshmërisë së aktit ndërkohë që ndryshimet e propozuara si nga ky Komision ashtu edhe në Komisionin përgjegjës janë të vogla dhe nuk prekin thelbin e ligjit.

Lidhur me tabelat e përputhshmërisë vihet re e nejtja problematikë sikurse edhe në ligjin e parë. Tabelat në kolonën e parë nuk përmbajnë të plotë tekstin e ligjit europian si edhe ka mospëputhje të vogla midis tekstit të ligjit shqiptar të botuar në fletoren zyrtare. METE për këtë projektligj ka paraqitur një tabelë.

III. Ligji Nr. 10 463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”

Institucioni propozues/përgjegjës: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Ligji është përgatitur me mbështetjen e Projektit “Plani Kombëtar i Zbatimit të Legjislacionit Mjedisor në Shqipëri” (INPAEL i financuar nga CARDS 2006).

Përmbajtja e ligjit: Projektligji synon të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit përmes parandalimit, minimizimit dhe menaxhimit të duhur të mbetjeve si dhe përdorimin e efektshëm të burimeve natyrore përmes ripërdorimit, riciklimit dhe rikuperimit të mbetjeve. Ai parashikon një hierarki në përcaktimin e përparësive në menaxhimin e mbetjeve që lidhet me parandalimin e mbetjeve, përgatitjen për ripërdorim, riciklimin, rikuperime të tjera dhe asgjësimin e mbetjeve.

Referenca në *acquis* e BE: Ligji Nr. 10 463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve përafuron plotësisht direktivën 2008/98/EC “Për mbetjet” e cila zëvendëson Direktivën 75/439/EEC, 91/689/EEC dhe 2006/12/EC si dhe përafuron pjesërisht:

1. Vendimin 2000/532/EC që përcakton një listë mbetjesh;
2. Direktivën 1999/31/EC për landfillin e mbetjeve;
3. Direktivën 2000/76/EC për incinerimin e mbetjeve;
4. Rregulloren (EC) 1069/2009 për nënproduktet shtazore;
5. Direktivën 94/62/EC për ambalazhet dhe mbetjet e ambalazheve;
6. Direktivën 2002/96/EC për mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike;
7. Direktivën 2000/53/EC për automjetet në fund të jetës;
8. Direktivën 2006/66/EC për bateritë dhe akumulatorët;

(vijon në faqen 5)

Vlerësimi i përputhshmërisë së ligjeve me *acquis* e BE-së dhe roli i Kuvendit në këtë proces

(vijon nga faqja 4)

9. Direktivën 2006/21/EC për mbetjet nga minierat;
10. Direktivën 96/59/EC për PCB/PCT;
11. Direktivën 86/278/EEC për mbrojtjen e mjedisit dhe në veçanti të tokës kur llumrat e ujërave të zeza përdoren në bujqësi
12. Direktivën 78/176/EEC për mbetjet nga industria e dioksidit të titaniumit;
13. Rregulloren (EC) 1013/2006 për transferimin e mbetjeve;
14. Direktivën 2000/59/EC për mjediset e pritjes në porte të mbetjeve që gjenerohen nga anijet dhe tepricat e mbetura prej kargove.

Relacioni i ligjit: Relacioni i ligjit 10 463 përmbush kërkesa e parashikuara në Rregulloren e Këshillit të Ministrave (VKM 584/2003 e ndryshuar).

1. Ai përmban institucionin përgjegjës dhe hartues të ligjit;
2. Jep detaje për statusin e ligjit dhe marrëdhëniet e tij me ligjet e tjera
3. Bën një referim tek MSA (3) përcakton nivelin e përafrimit dhe jep arsyet e përafrimit të pjesshëm për disa akte të *acquis* së BE-së
4. Përmban tabelat e përputhshmërisë
5. Jep shkaqet për shkallën e përputhshmërisë së përzgjedhur.
6. Jep detaje për aktet nënligjore që të hartohen. Përmban parashikime financiare për zbatimin e ligjit, nivelin e investimeve të nevojshme, nevojën për ngritjen e institucioneve të reja dhe angazhimin e specialisteve të rinj
7. Nuk përmban konfirmimin nga MoEI

Tabelat e përputhshmërisë: Projektligji është i shoqëruar nga tabelat e përputhshmërisë në përputhje me Instrumentet e përafrimit.

Komente të përgjithshme

Ligji Nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” është një ligj integral për menaxhimin e mbetjeve i cili shfuqizon dy ligje të mëparshëm, ligjin 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin e mbetjeve të ngurta” dhe ligjin 9537, datë 18.05.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”. Ligji në fjalë është përgatitur me asistencën e BE-së nëpërmjet Projektit INPAEL i cili ka mbështetur Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Ligji përafrohet plotësisht Direktivën 2008/98/EC “Për mbetjet” dhe përafrohet pjesërisht një sërë direktivash të tjera, duke krijuar në ligj bazën e nevojshme ligjore për nxjerrjen e akteve të mëvonshme nënligjore për plotësimin e gjithë kuadrit ligjor për mbrojtjen e mjedisit.

Nga studimi i dokumenteve shoqëruese të projektligjit rezultojnë se instrumentet e përafrimit janë plotësuar në rregull. Tabelat e përputhshmërisë janë plotësuar në rregull. Ato reflektojnë saktë shkallën e përputhshmërisë e cila citohet edhe në relacionin shoqëruar të ligjit. Duke marrë

parasysh natyrën shumë teknike të direktivave të përafuara përafrimi është kryer me mënyrën ‘copy – paste’ të tekstit të direktivës apo duke përkthyer *ad litteram* nenet e direktivës. Megjithatë, është për tu theksuar se, edhe pse kjo mënyrë siguron nganjëherë përafrim të mirë, sidomos në rastin e direktivave me karakter teknik, kjo nuk është mënyra më e mirë e përafrimit.

Në variantin përfundimtar të ligjit, si shënim në fund të faqes, i lidhur me titullin e ligjit, jepet vetëm Direktiva 2008/98/EC “Për mbetjet”, direktiva e vetme e përafuar plotësisht. Sipas kërkesave të Rregullores së Këshillit të Ministrave në fund të faqes duhen shënuar të gjitha aktet e *acquis* së BE-së të cilat përafrohen, pavarësisht shkallës së përafrimit. Edhe pse nuk e kemi parë variantin qeveritar të ligjit, propozimin për të riformuluar shënimin në fund të faqes e gjejmë në raportin e përgatitur nga Komisioni i Integritimit Evropian.

Nga relacioni shoqëruar i ligjit kuptojmë gjithashtu se ka pasur një përpjekje për vlerësimin e ndikimit rregullator të ligjit. Në relacionin ka parashikime financiare të nevojshme për zbatimin e ligjit, nivelin e investimeve të nevojshme dhe burimet se nga mund të nxirren këto investime, numrin e specialisteve të administratës publike në nivel qendror dhe vendor që do të duhet të angazhohen për zbatimin e ligjit etj. Gjithashtu, relacioni jep informacion të përgjithshëm edhe mbi procesin e konsultimit të projektligjit me përfaqësues të strukturave të vetë Ministrisë së Mjedisit dhe Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve si dhe me publikun dhe OJF-te mjedisore nëpërmjet organizimit të debateve të hapura.

Përveç relacionit shoqëruar, nga raportet e përgatitura në Kuvend, sidomos nga raporti i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, i cili është dhe Komisioni përgjegjës, dhe i Komisionit për Integritimin Evropian, rezultojnë se Kuvendi nuk është mjaftuar me projektin e paraqitur në Kuvend nga Qeveria. Përkundrazi, të dy Komisionet e Kuvendit kanë paraqitur propozime për ndryshime të mjaft neneve të projektligjit. Kështu, Komisioni përgjegjës ka paraqitur propozime për afërsisht gjysmën e neneve të ligjit të cilat janë marrë parasysh dhe janë reflektuar në tekstin final të ligjit.

IV. Ligji Nr. 10 385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

Institucioni propozues/përgjegjës: Ministria e Drejtësisë. Ligji është përgatitur edhe me ndihmën e Misionit EURALIUS II dhe International Finance Corporations.

Përmbajtja e ligjit: Ligji synon përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor ekzistues në fushën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nëpërmjet veprimtarisë jashtëgjyqësore të ndërmjetësimit, si rrugë alternative, krahas asaj gjyqësore. Ai reflekton ndryshimet e ndodhura

(vijon në faqen 6)

Vlerësimi i përputhshmërisë së ligjeve me *acquis* e BE-së dhe roli i Kuvendit në këtë proces

(vijon nga faqja 5)

gjatë zbatimit në praktikë të ligjit ekzistues të vitit 1993, si dhe mban në konsideratë rekomandimet e shoqërisë civile dhe të institucioneve ndërkombëtare. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve parashikohet të realizohet nëpërmjet veprimtarisë së ushtruar nga persona të tretë, të quajtur ndërmjetës, të cilët licencohen nga një komisioni i posaçëm pranë Ministrisë së Drejtësisë. Ligji parashikon organizimin e ndërmjetësve rreth Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, si person juridik që ushtron veprimtarinë në mënyrë të pavarur nga shteti.

Referenca në *acquis* e BE: Ligji Nr. 10 385, date 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” përaftron plotësisht Direktivën 2008/52/EC “Mbi disa aspekte të ndërmjetësimin në çështjet civile dhe tregtare”.

Relacioni i ligjit: Relacioni i ligjit 10 463 përmbush disa prej kërkesave të parashikuara në Rregulloren e Këshillit të Ministrave (VKM 584/2003 e ndryshuar).

1. Ai përmban institucionin përgjegjës dhe hartues të ligjit
2. Jep detaje për statusin e ligjit dhe marrëdhëniet e tij me ligjet e tjera
3. Nuk bën referim tek MSA
4. Përcakton nivelin e përafrimit
5. Përmban tabelat e përputhshmërisë
6. Përmban parashikime për nxjerrjen e akteve nënligjore. uk përmban parashikime financiare për zbatimin e ligjit
7. Nuk përmban konfirmimin nga MoEI

Tabelat e përputhshmërisë: Projektligji është i shoqëruar nga tabelat e përputhshmërisë në përputhje me Instrumentet e përafrimit.

Komente të përgjithshme

Ligji Nr. 10 385, date 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” është një ligj i ri i cili synon zgjidhjen vullnetare, ‘miqësore’ ose me pajtim të mosmarrëveshjeve në fushat civile, tregtare, familjare, të punës. Ai i shtrin efektet e tij edhe në mosmarrëveshjet në fushën penale që shqyrtohen nga gjykata me kërkesë të të dëmtuarit akuzues në përputhje me nenet 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale. Ky ligj shfuqizon ligjin e mëparshëm Nr. 9090, datë 26.06.2003 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”. Ligji në fjalë është përgatitur me asistencën e BE-së nëpërmjet Misionit EURALIUS i cili ka mbështetur Ministrinë e Drejtësisë. Ligji përaftron plotësisht Direktivën 2008/52/EC “Mbi disa aspekte të ndërmjetësimin në çështjet civile dhe tregtare”.

Nga studimi i dokumenteve shoqëruese të projektligjit rezulton se instrumentet e përafrimit janë plotësuar në rregull. Megjithatë, tabelat e përputhshmërisë, edhe pse janë plotësuar, nuk i përmbajnë të gjitha nenet e Direktivës, duke

lenë jashtë ato nene të cilat nuk janë relevante ose i drejtohen Shteteve Anëtare. Keto nene duhet të ishin përfshirë gjithashtu në tabelë duke dhënë edhe komentimin përkatës se përse nuk janë përafruar. Gjithashtu, ndryshimet e bëra në projektligj gjatë shqyrtimit të tij në Kuvend nuk janë reflektuar në tabelat e përputhshmërisë. Si rrjedhojë, renditja e çështjeve në tekstin përfundimtar të ligjit nuk përkon me renditjen e çështjeve në variantin që gjejmë në tabelat e përputhshmërisë. Megjithatë, kjo nuk ka cënuar nivelin e përputhshmërisë të variantit përfundimtar.

Në variantin përfundimtar të ligjit, si shënim në fund të faqes, i lidhur me titullin e ligjit, jepet Direktiva 2008/52/EC “Mbi disa aspekte të ndërmjetësimin në çështjet civile dhe tregtare”. Nga raporti i Komisionit për Integrimin Evropian kuptojmë se ka pasur një debat mes deputeteve mbi nivelin e përafrimit të Direktivës. Edhe pse Direktiva e BE-së synon zbatimin e ndërmjetësimin për mosmarrëveshjet ndërkufitare, vetë Direktiva në preambulën e saj, në paragrafin 8, sqaron se Shtete Anëtare mund të përdorin këto rregulla edhe për procesin e brendshëm të ndërmjetësimin. Megjithatë, edhe ligji shqiptar në pikën 8 të nenit 2 mundëson zbatimin e rregullave të ndërmjetësimin edhe në rastin kur vetëm njëra nga palët në konflikt ka vendbanimin në Republikën e Shqipërisë.

Nga relacioni shoqërues i ligjit kuptojmë gjithashtu se ka pasur një përpjekje për vlerësimin e ndikimit rregullator të ligjit. Në relacion nuk ka parashikime financiare të nevojshme për zbatimin e ligjit dhe as parashikime mbi të ardhurat që mund të sjellë ky ligj, por parashikohet se zbatimi i tij do të sjellë ulje të kostove të proceseve gjyqësore nëpërmjet reduktimit të kohës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Gjithashtu, relacioni jep informacion të përgjithshëm edhe mbi procesin e konsultimit të projektligjit me përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Projektligji është hartuar në bashkëpunim me Fondacionin për Zgjidhjen e Konfliktëve si dhe ka marrë asistencën e Misionit EURALIUS dhe IFC-së. Sipas raportit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ligji i është nënshtruar një procesi konsultimi mjaft të gjerë ku janë reflektuar të gjitha mendimet dhe sugjerimet e dhëna për të.

Përveç relacionit shoqërues, nga raportet e përgatitura në Kuvend, sidomos nga raporti i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, i cili është dhe Komisioni përgjegjës, dhe i Komisionit për Integrimin Evropian, rezulton se Kuvendi nuk është mjaftuar me projektin e paraqitur në Kuvend nga Qeveria. Përkundrazi, të dy Komisionet e Kuvendit kanë paraqitur propozime për ndryshime për pothuajse të gjitha nenet e projektligjit të cilat janë marrë parasysh dhe janë reflektuar në tekstin final të ligjit. Komisioni për Ekonominë dhe

(vijon në faqen 7)

Vlerësimi i përputhshmërisë së ligjeve me *acquis* e BE-së dhe roli i Kuvendit në këtë proces

(vijon nga faqja 6)

Financat nuk ka paraqitur ndryshime por është mjaftuar me miratimin e projektit.

V. Ligji Nr. 10 385, datë 24.02.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”

Institucioni propozues/përgjegjës: Ministria e Shëndetësisë.

Përmbajtja e ligjit: Ligji ka si qëllim kontrollin e ekspozimit të publikut dhe të punonjësve, si dhe monitorimin e rrezatimeve jojonizuese duke shfrytëzuar të mirat që vijnë nga përdorimi i tyre. Ligji përcakton masat që synojnë mbrojtjen e publikut dhe të punonjësve nga efektet dëmtoese në shëndet si rezultat i ekspozimit të tyre ndaj rrezatimeve jojonizuese në intervalin e frekuencave 0 – 300 GHz.

Referenca në *acquis* e BE: Ligji Nr. 10 385, datë 24.02.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese” nuk përafuron ndonjë akt normativ të *acquis* së BE-së. Megjithatë ai merr parasysh Rekomandimin e Këshillit të Bashkimit Evropian 1999/519/EC mbi kufizimin e ekspozimit të publikut ndaj fushave elektromagnetike (0 Hz – 300 GHz).

Relacioni i ligjit: Relacioni i ligjit 10 385 përmbush disa prej kërkesave të parashikuara në Rregulloren e Këshillit të Ministrave (VKM 584/2003 e ndryshuar).

1. Ai përmban institucionin përgjegjës dhe hartues të ligjit
2. Nuk jep detaje për statusin e ligjit dhe marrëdhëniet e tij me ligjet e tjera
3. Nuk bën referim tek MSA
4. Përmban parashikime për nxjerrjen e akteve nënligjore
5. Nuk përmban tabelat e përpueshshmërisë
6. Jep një përmbledhje të përmbajtjes së ligjit dhe nuk përmban parashikime financiare për zbatimin e ligjit.
7. Nuk përmban konfirmimin nga Ministria e Integritimit.

Tabelat e përputhshmërisë: Projektligji nuk është i shoqëruar nga tabelat e përputhshmërisë duke qenë se ai nuk përafuron ndonjë akt normativ të *acquis* së BE-së.

Komente të përgjithshme

Nr. 10 385, datë 24.02.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese” është një ligj i ri i cili synon mbrojtjen e punëtorëve dhe publikut nga ekspozimi ndaj rrezatimeve jojonizuese. Ai është një ligj kuadër dhe nuk përmban rregulla teknike. Elementet teknike si dhe përcaktimi i niveleve të kufizimeve do të bëhen me anë të rregulloreve të cilat do të përgatiten nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe do të miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Nga studimi i dokumenteve shoqëruese të projektligjit rezultojnë se instrumentet e përafurimit nuk janë plotësuar. Kjo për faktin se ligji nuk përafuron ndonjë akt normativ të *acquis* së BE-së. Megjithatë ligji merr në konsideratë

Rekomandimin e Këshillit të Bashkimit Evropian 1999/519/EC mbi kufizimin e ekspozimit të publikut ndaj fushave elektromagnetike (0 Hz – 300 GHz), materiale të Organizatës Botërore të Shëndetësisë si dhe strukturat analoge në vendet e tjera. Ka pasur debat në Komisionin e Integritimit dhe një pjesë e deputetëve të opozitës janë shprehur kundër ligjit me argumentin se ai nuk përafuron ndonjë akt të *acquis* së BE-së duke e bërë të paqartë referencën e përafurimit në normativën e Bashkimit Evropian. I njëjti shqetësim ngrihet edhe nga disa deputetë opozitarë të Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Megjithatë, as Komisioni i Integritimit dhe as Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë nuk ka rekomanduar dhe as ne nuk gjetëm ndonjë akt normativ të *acquis* së BE-së në këtë fushë që mund të përafrohej me ligjin në fjalë.

Nga studimi i relacioni shoqërues i ligjit nuk kuptohet nëse ka pasur një përpjekje për vlerësimin e ndikimit rregullator të ligjit. Në relacion nuk ka parashikime financiare të nevojshme për zbatimin e ligjit dhe as parashikime mbi të ardhurat që mund të sjellë ky ligj. Gjithashtu, ligji nuk duket t’i jetë nënshtruar ndonjë procesi konsultimi me përfaqësues të subjekteve të interesuara sic mund të jenë qytetarët ose bizneset, produktet e të cilave emetojnë rrezatim jojonizues. Kjo mangësi është vënë në dukje në raport edhe nga Komisioni i Integritimit.

Edhe ky ligj, ashtu si edhe ligjet e tjera të analizuar, ka pësuar ndryshime gjatë shqyrtimit të tij në Kuvend. Kjo rezultojnë nga studimi i raportit të Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, i cili është Komisioni përgjegjës dhe ka paraqitur propozime për ndryshime për disa nene të projektligjit të cilat janë marrë parasysh dhe janë reflektuar në tekstin final të ligjit. Komisioni i Integritimit nuk ka paraqitur ndryshime por është mjaftuar me miratimin e projektit.

Konkluzione dhe rekomandime

Nga analiza që i bëhet pesë ligjeve të miratuara nga Kuvendi gjatë vitit 2011, përkundrejt detyrimeve ligjore dhe dokumentave shoqëruese të këtyre ligjeve, mund të themi si konkluzion të përgjithshëm **që në përgjithësi institucionet shqiptare kur hartojnë ligjet marrin parasysh kërkesat formale për përafurimin e legjislacionit**. Nga pesë ligje të përzgjedhura vetëm njëri prej tyre nuk ishte i shoqëruar me tabelat e përputhshmërisë.

Kuvendi i Shqipërisë dhe strukturat e tij përkatëse, realizojnë kontrollin formal dhe material të ligjeve përpara se ato të miratohen në seancë plenare.

Duhet theksuar se një rol të rëndësishëm përveç institucioneve shqiptare luajnë dhe projektet e asistencës teknike të BE-së apo ekspertiza që ofrohet për këtë proces

(vijon në faqen 8)

Vlerësimi i përputhshmërisë së ligjeve me *acquis* e BE-së dhe roli i Kuvendit në këtë proces

(vijon nga faqja 7)

të cilat kontribuojnë pozitivisht në rritjen e cilësisë së ligjeve të përafuara, sidomos për plotësimin e tabelave.

Megjithatë, vihen re probleme në përmbajtjen e relacionit dhe plotësimin e tabelave. Relacionet në përgjithësi janë të thata, ato nuk përmbajnë shumë argumenta sidomos për nivelin e përafritit të përzgjedhur dhe kohës se kur do të kryhet përafrimi i plotë. Pothuajse në asnjë rast relacioni nuk përmban konfirmimin e MoEI.

Në disa raste institucionet dorëzojnë vetëm një tabelë. Në këtë pikë do të ishte mirë të bëheshin ndryshimet përkatëse tek Instrumentat e përafritit të cilat do të mund të lehtësonin punën e institucioneve në përgatitjen e tabelave.

Tabelat nuk përmbajnë të plotë ligjin europian. Kjo është një qasje e gabuar e cila deformon jo vetëm thelbin e procesit të përafritit por nuk orienton asnjë institucion të interesuar për perspektivën e këtij procesi për ligjin në fjalë. Pra kur do të përafrohet plotësisht ligji dhe cilat janë shkaqet e përafritit të pjesëshëm.

Analiza paraprake e kostove të ligjeve bëhet në pak raste dhe në përgjithësi ajo është e cekët. Është e rëndësishme që të miratohen rregulla detyruese për analizën e vlerësimit ligjeve pasi ajo ndihmon shumë dhe procesin e përafritit.

Relacioni i depozituar në Kuvend nuk përmban certifikimin e kryer nga MoEI. Do të ishte e rekomandueshme që certifikimi i MoEI për aktin e përafuar të depozitohet edhe në Kuvend. Kontrolli nga ana MoEI mund të përfshihet në relacion ose të depozitohet si një raport me vetë në dokumentat shoqërues të ligjit.

Tabelat e përputhshmërisë, në variantin që dërgohen nga Qeveria, përmbajnë tekstin e projektligjit dhe jo versionin e tij final. Duke parë se pothuajse të gjithë ligjet pësojnë ndryshime gjatë shqyrtimit të tyre në Kuvend duhet që këto ndryshime të reflektohen në tabelat e përputhshmërisë. Kjo aktualisht nuk ndodh duke rezultuar në mospërputhje të tekstit në tabelat e përputhshmërisë me tekstin e ligjit final të miratuar. Do të ishte e domosdoshme unifikimi i praktikës dhe përcaktimi i rregullave të qarta se çfarë duhet bërë pas shqyrtimit të ligjeve në kuvend. Duhet përcaktuar dhe struktura përgjegjëse e cila duhet të mbajë të përditësuar dhe uniforme dokumentat shoqëruese të ligjit.

Erion Fejzulla
Aida Gugu

Qendra e Studimeve Parlamentare

¹ Marrëveshja Ekonomike me Komunitetin Europian është lidhur në vitin 1992

² Drejtoria e Përafritit u krijua fillimisht pranë Këshillit të Ministrave (1999) për të kaluar në Ministrinë e Drejtësisë dhe me krijimin e Ministrisë së Integritit pranë kësaj Ministrie (2004).

³ Me ndryshimet strukturore të MoEI në vitin 2005 u shkri drejtoria e përafritit dhe u krijuan dy drejtori të reja ajo e tregut të brendshëm dhe e drejtësisë dhe punëve të brendshme.

⁴ Ky komitet drejtohet Ministria e Integritit dhe në përbërje të tij janë zëvendës ministra dhe sekretarë të përgjithshëm si drejtues të institucioneve të pavarura.

⁵ Grupet ndër-institucionale të punës janë të ndarë sipas kapitujve të *acquis* dhe ato janë përgjegjës për përafritin e legjislacionit. Urdhëri i Kryeministrit nr. 46 datë 1.04.2006.

⁶ Komisioni I Integritit në punën e tij të kontrollit parlamentar të përafritit të ligjeve asistohet nga një strukturë administrative që është Njësia e Përafritit të Legjislacionit.

⁷ Pikat 12 dhe 19 (ç) të Rregullores të Këshillit të Ministrave.

⁸ Grupet Institucionale të Punës janë ngritur me Urdhër të Kryeministrit nr.183, datë 11.12.2009.

⁹ Ndryshimet e vitit 2006 të Rregullores së Këshillit të Ministrave përfshin si një aneks bashkëngjitur rregullores Instrumentat e përafritit. VKM nr. 201, datë 29.03.2006

¹⁰ Pika 25 e Rregullores së Këshillit të Ministrave.

¹¹ Pikat 68/2 dhe 68/4 të Rregullore së Kuvendit.

¹² Shih Manualin e Hartimit të Legjislacionit

¹³ Pika 21.1 e Rregullores së Këshillit të Ministrave

¹⁴ Shih: raport i komisionit të Integritit për projektligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore I cili parashikon se projektligji është përputhje me nenin 19 dhe nenin 68 të Rregullores së Kuvendit.

Zhvillimet Kushtetuese të Traktatit të Lisbonës në fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë në nivel mbikombëtar dhe kombëtar

Abstrakt

Për të vlerësuar zhvillimet kushtetuese në fushën e lirisë, sigurisë dhe të drejtësisë (LSD), të Traktatit të Lisbonës, do të shqyrtojmë fillimisht nenet e reja në fushën e (LSD). Në vazhdim do të flasim për impaktin e tyre në rendet e brendshme kushtetuese mbikombëtare dhe kombëtare dhe ndryshimet në Traktatin e Nicës. Më pas do të trajtojmë disa kazuse të Gjykatës së Drejtësisë duke interpretuar Shtyllën e Tretë të vjetër, dhe krahasuar atë me sfidat e e reja të Traktatit të Lisbonës.

Fjalët kyçe: Legjislacioni kushtetues i BE-së, legjislacioni kushtetues kombëtar, Traktati i Lisbonës, Gjykata Evropiane e Drejtësisë

1. Prezantim i neneve të reja në Fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë të Traktatit të Lisbonës

Traktati i Lisbonës solli disa ndryshime në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, brenda struktues së tij. Për pasojë, juridiksioni i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë u shtri në të gjithë legjislacionin e BE-së, duke përfshirë edhe fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Proçedura e rregullave parapërgatitore duhet të përshtatet sipas nevojave të fushës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë (nenet 267 dhe 276), me përjashtime për rishikimin policor dhe shërbime të tjera të zbatimit të ligjit si dhe për ruajtjen e sigurisë së brendshme. Për çështjet e vrasjeve u parashikuan procedura parapërgatitore të menjëhershme.

Traktati i Lisbonës solli disa ndryshime domethënëse në arkitekturën e BE-së, duke hequr shtyllën e tretë dhe duke e zëvendësuar atë, me fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, që do të thotë se rregullat e Komunitetit Evropian zbatohen edhe ndaj fushës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Kjo konsiderohet si një “komunitarizim” i fushës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Pasoja e këtij ndryshimi do të bëhet më transparente dhe më efikase sidomos duke iu referuar zbatimit të efekteve ligore (supremacisë dhe të efektit të drejtpërdrejtë) në shtetin e së drejtës në tregun e brendshëm.

Nenet e fushës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë janë të parashikuara në nenet 67-89 të Traktatit të Lisbonës dhe konkretisht në pesë kapitujt e mëposhtëm:

Kapitulli 1 Dispozita të Përgjithshme;

Kapitulli 2 Politikat për kontrollin e kufitare, azilin dhe imigrimin;

Kapitulli 3 Bashkëpunimi gjyqësor në çështje civile;

Kapitulli 4 Bashkëpunimi gjyqësor në çështje penale; dhe

Kapitulli 5 Bashkëpunimi policor.

Objektivat e BE-së duke iu referuar nenit 3 të Traktatit të Bashkimit Evropian të Traktatit të Lisbonës, parashtrihen si më poshtë:

“2. Bashkimi iu ofron qytetarëve të tij një zone lirie, sigurie dhe drejtësie pa kufij të brendshëm në të cilën

sigurohet lëvizja e lire e njerëzve së bashku me masat e duhura sa i takon kontrollin të kufijve, azilit, imigracionit dhe parandalimit të luftës kundër krimit.

3. Bashkimi krijon një treg të brendshëm [...]”.

Në nenin 3 të Traktatit të Bashkimit Evropian, fusha e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë ka “lëvizur nga lista” dhe është vendosur përpara tregut të brendshëm. Kjo tregon interesin dhe rendësinë e kësaj fushe.

Fusha e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë synon të jetë një fushë si tregu i brendshëm, që mbetet brenda kompetencave të ndara. Gjithsesi duke iu referuar nenit 2, paragrafi (2) të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian “Kompetenca e ndarë midis Bashkimit dhe vendeve anëtare” tregu i brendshëm është më lartë në listë sesa fusha e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

Përse në fushat e ndarjes së pushteteve, fusha e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë renditet pas fushës së tregut të brendshëm? Përgjigja duhet të jetë “sepse pushtetet e Bashkimit janë të kufizuara dhe jo gjithmonë të qarta për sa i përket mundësive jashtë dhe mundësive brenda”. Pushtetet e qarta nuk janë gjithnjë të lehta për t’u gjendur pasi janë shumë Traktate mbi bashkëpunimin në fushën e drejtësisë që janë gjithashtu të paazhornuara.

Natyrë e ndarjes së pushteteve në tregun e brendshëm si dhe në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë midis BE-së dhe vendeve anëtare mund të përcaktohet duke shqyrtuar në detaje nenet dhe interpretimin teorik të tyre.

Vendet anëtare do të humbasin kompetencat e tyre brenda regjimit të ndarjes së pushteteve sepse Bashkimi i ka ushtruar kompetencat e tij. Ndërsa kompetenca të cilat nuk janë transferuar ende tek BE-ja do t’i mbeten vendeve anëtare. Ndoshta në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, vendet anëtare kanë frikë të humbasin kompetencat e tyre, më shumë sesa në fushën e tregut të brendshëm.

2. Aktet ligjore në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë

Regjimi i përgjithshëm i akteve ligjore, i cili parashikohet në nenet 288-294 të TFBE, të Traktatit të Lisbonës, zbatohet për masat e miratuara në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Institucionet mund të miratojnë aktet ligjore si: direktivat, rregulloret dhe vendimet. Këto akte, zëvendësojnë aktet në kuadër të nenit 34 të Traktatit të Nicës (pozicione të përbashkëta, vendime kuadër, konventa). Vendimi kuadër është ekuivalent i direktivave të Lisbonës, gjithsesi në nenin 34 të BE-së, citohet se këto vendime nuk kanë efektin e drejtpërdrejtë¹.

Në Traktatin e Lisbonës një direktive legjislative, e deleguar ose zbatuese që i përket fushës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, ka efekt të drejtpërdrejtë, duke iu referuar kritereve të doktrinës.

Në këtë fushë mund të ketë konflikt midis akteve të Bashkimit dhe dispozitave kushtetuese kombëtare. Pyetja

(vijon në faqen 10)

Zhvillimet Kushtetuese të Traktatit të Lisbonës në fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë në nivel mbikombëtar dhe kombëtar

(vijon nga faqja 9)

ngrihet nëse ka një ndryshim të efekteve kushtetuese të akteve ligjore në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë me çështjet ligjore të tregut të brendshëm. A kanë prioritet ose përparësi këto akte ndaj rendit të brendshëm ligjor (kushtetuta dhe ligjet)?

3. Objektivat kryesore të fushës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë

Neni 67 i TFBE është neni më i rëndësishme për fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë në Traktatin e Lisbonës:

“1) Bashkimi përbën një zone lirie, sigurie dhe drejtësie, lidhur me respektimin e të drejtave themelore, sistemeve dhe traditave të ndryshme juridike të Shteteve Anëtare.

2) Ai garanton heqjen e kontrolleve të kufijve të brendshëm për personat dhe përcakton politikë të përbashkët për azilin, imigracionin dhe kontrollin e kufijve të jashtëm.

3) Bashkimi bën përpjekje për të siguruar një nivel të lartë sigurie përmes masave për parandalimin dhe luftën kundër kriminalitetit, racizmit dhe ksenofobisë dhe përmes masave për bashkërendim dhe bashkëpunim midis autoriteteve policore dhe gjyqësore dhe autoriteteve të tjera kompetente, si dhe përmes njohjes së ndërsjelltë të aktgjyqimeve në çështjet penale dhe nëse është nevoja përmes përafritimit të legjislacionit.

4) Bashkimi mundëson ushtrimin e të drejtës për t’iu drejtuar sistemit të drejtësisë, sidomos përmes parimit të njohjes së ndërsjelltë të vendimeve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në çështjet civile”.

Këto nene zëvendësojnë nenin 61 të Komunitetit Evropian dhe ish nenin 29 të Traktatit të Bashkimit Evropian nga shtylla e tretë e cila parashikonte shumë vendime kuadër dhe masa të tjera që janë interpretuar në disa vendime të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, përpara se të hynte në fuqi Traktati i Lisbonës. Sa më poshtë kemi përzgjedhur disa vendime, në të cilat zbatohen objektivat e përmendur më lartë dhe gjithashtu komentohen ndryshimet e Traktatit të Lisbonës.

4. Mbrojtja e të drejtave themelore, BE-ja dhe vendimet e brendshme kombëtare për parandalimin dhe luftën ndaj terrorizmit

Në vendimin e dhënë nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë², në 3 shtator të vitit 2008, lidhur me sanksionet ekonomike të individëve, sipas një rezolute të Kombeve të Bashkuara, është bërë e qartë, se në të gjitha rrethanat, të drejtat themelore të njeriut të qytetarëve të BE-së duhet të respektohen kur BE-ja miraton masa, që parashikojnë të drejta si, zhvillimi një gjykimi të drejtë pavarësisht detyrimeve ndërkombëtare.

GJED anuloi vendimin e dhënë nga gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për çështjen Kadi dhe Yusuf dhe anuloi Rregulloren e Këshillit 881/2002, e cila

parashikonte masa kufizuese ndaj personave dhe entiteteve që asociohen me Osama bin Laden, rrjeti Al-Qaeda, dhe Taliban, sepse gjeti një degë të të drejtave themelore të Bashkimit Evropian.

Gjykata anuloi Rregulloren e Këshillit pasi në bazë të saj ishin ngrirë fondet e Z. Kadi dhe Z. Albarakaat; dhe nuk ishin zbatuar të drejtat e mbrojtjes, në veçanti e drejta për t’u dëgjuar dhe e drejta për të rishikuar vendimin gjyqësor. Gjykata më pas konkludoi se, ngrirja e fondeve përbën një kufizim të të drejtave për pronësi të Z. Kadi.

Ky vendim lë një game të gjërë interpretimesh lidhur me bashkëveprimin midis zbatimit të së drejtës ndërkombëtare në të drejtën e BE-së, si dhe bie në kundërshtim me zbatimin e legjislacionit të brendshëm në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

Në këtë çështje, aktet e Bashkimit Evropian duhet të zbatohen ashtu si rezoluta e Këshillit të Sigurisë 1267 (1999). Yusuf dhe Kadi argumentuan se rregullorja bie në kundërshtim me të drejtat themelore, në veçanti të drejtat e tyre për përdorimin e pronës vetjake dhe të drejtën e një séance dëgjimore, siç parashikon neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Kjo rregullore parashikon zbatimin e sanksioneve të rënda, civile dhe penale ndaj këtyre personave, edhe pse ata nuk janë dëgjuar më parë, ose iu është dhënë mundësia për të mbrojtur veten e tyre. Gjithashtu personat e dëmtuar theksojnë se atyre nuk iu është thenë përse ndaj tyre janë zbatuar sanksionet e mësipërme.

Neni 75 i Traktatit të Lisbonës është hartuar në mënyrë që të adresojë problemet ligjore të ngritura në çështjen ligjore Kadi, çështje e cila krijoi si precedent, anulimin e Rregullores së Këshillit nr. 881/2002, në bazë të së cilës u ngrinë asetet e personave fizikë dhe juridikë, në kuadër të politikave kundër terrorizmit, të drejtave themelore dhe vendimeve të Këshillit për siguri. Ky nen i jep pushtet BE-së të miratojë masa kufizuese ndaj individëve, si ngrirja e fondeve ose asetëve financiare dhe ekonomike, që i përkasin ose janë në pronësi të personave juridikë ose fizikë, grupeve ose entiteve jo shtetërore.

Duke përfshirë nenin 75 të TFBE në Traktatin e Lisbonës, çështja Kadi ka efekt institucional në rendin ligjor mbikombëtar.

Çështja Kadi, tregon për ndikimin e zhvillimit të efektit ligjor dhe rezolutave të organizatave ndërkombëtare, në rendin ligjor të BE-së dhe si pasojë, edhe ndikimin në rendin e brendshëm ligjor të vendeve anëtare.

Zhvillimet në rendin ligjor ndërkombëtar ndikojnë në interpretimin e traktateve ndërkombëtare në kuadër të Kushtetutës Holandeze, dhe epërsinë e saj në ligjet holandeze. Sipas teorisë së “neo-minizmit”³ epërsia e vendimeve ndërkombëtare në Hollandë do të jetë tashmë e kufizuar nga parimet themelore të Kushtetutës Holandeze

(vijon në faqen 11)

Zhvillimet Kushtetuese të Traktatit të Lisbonës në fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë në nivel mbikombëtar dhe kombëtar

(vijon nga faqja 10)

dhe rendit të saj të brendshëm, të cilët janë të njëjtë me të drejtat themelore të shkelura në rastin e çështjes Kadi. Autori Bogdandy⁴ citon si më poshtë:

“Duhet të ekzistojë gjithnjë mundësia, të paktën në demokracitë liberale, që ligjërisht, të kufizohet efekti i normave ose i akteve ndërkombëtare brenda rendit të brendshëm ligjor nëse ka mospërputhje me parimet kushtetuese. Kjo përputhet si me legjislacionin ndërkombëtar ashtu edhe me aktet ndërkombëtare [...]”.

Komenti i fundit është se për aktet (rregullore, direktiva) të miratuara me nenet 288-294 në Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, në fushën e luftës ndaj terrorizmit, efekti i drejtpërdrejtë si në rastin e çështjes Kadi, kufizohet për t’u zbatuar, për shkak të rendit të brendshëm ligjor holandez, edhe pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës.

5. Zhvillimet kushtetuese në dhënien e vendimeve 5.1. Roli i Parlamenteve Kombëtare

Roli i Parlamenteve Kombëtare është rritur. Psh, neni 69 i TFBE (parimi i subsidiaritetit) dhe neni 70 TFBE (vlerësimi i politikave të Bashkimit, si për shembull, monitorimi i Europol dhe Eurojust) konsiderohen si një zhvillim kushtetues shumë i rëndësishëm. Në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile duke iu referuar nenit 81 (3) të TFBA, Parlamenti i një vendi anëtar, mund të vendosë veton, për miratimin e Vendimit të Këshillit të BE-së, për çështjet e zbatimit të legjislacionit të familjes në vendet ndërkuftare.

5.2. Dimensionin ndërkuftar i krimit

Kompetencat e BE-së për të zbatuar masat që lidhen me legjislacionin penal tashmë specifikohen në nenin 83 të TFBE: terrorizmi, trafikimi i qënieve njerëzore, trafikimi i lëndëve narkotike, trafikimi i armëve, pastrimi i parave, falsifikimi në dhënien e pagesave, krimi kompjuterik, dhe krimi i organizuar. Dimensionin ndërkuftar i krimit është një kërkesë e BE-së. Edhe përpara miratimit të Traktatit të Lisbonës, ekzistonin kompetenca të BE-së për procedurat penale.

5.3. Mbrojtja e aspekteve themelore të sistemit kombëtar të drejtësisë penale

Në paragrafin 3, të Nenit 82 të TFBE dhe nenin 83 të TFBE, janë parashikuar “frena emergjence”: “Kur një anëtar i Këshillit mendon se një projekt direktivë, e përmendur në paragrafin 2, do të prekte aspektet themelore të sistemit të tij të drejtësisë penale, ai mund të kërkojë që projekt direktiva t’i përcillet Këshillit Evropian”. Ndjeshmëria e kësaj fushe lidhet me krijimin e “frenave të dorës”.

5.4. Njohja e vendimeve gjyqësore dhe përafrimit të legjislacionit në fushën penale

Në fushën e bashkëpunimit gjyqësor, në nenet 82 (2) të TFBE dhe 83 (3) të TFBE, përcaktohet se bashkëpunimi gjyqësor do të mbështetet në parimet e njohjes të ndërsjelltë të vendimeve gjyqësore dhe do të përfshijë edhe përafrimin e legjislacionit dhe rregulloret e vendeve anëtare në fushat respektive.

Parlamenti Evropian dhe Këshilli, duke vepruar në përputhje me procedurën e zakonshme legjislative, do të miratojë masat e nevojshme.

Që nga miratimi i Përfundimeve të Këshillit Evropian “Tampehe” (1999), parimi i njohjes së ndërsjelltë, konsiderohet si gurthemeli i legjislacionit penal Evropian. Zbatimi i këtij parimi mund të jetë i suksesshëm, nëse ka një besim të ndërsjelltë midis vendeve anëtare për sistemet e tyre ligjore, të cilat do të jenë më të lehta për t’u realizuar nëse ndërmerren disa forma harmonizimi, si nga ana formale ashtu edhe ajo procedurale.

Qëndësia e njohjes së ndërsjelltë parashikohet në Traktatin e Lisbonës. Në të vërtetë, zbatimi i njohjes së ndërsjelltë për sferën penale ka qenë problematike. Në lidhje me bashkëpunimin policor dhe veçanësisht lidhur me shkëmbimin e informacionit për të drejtat themelore individuale ekzistojnë rreziqe në dy fusha: të dhënat personale dhe mbrojtja ligjore.

Të drejtat themelore në fushën e bashkëpunimit gjyqësor lidhen me miratimin e akteve për asistencën ligjore të ndërsjelltë, ekstradimin dhe ekzekutimin e vendimeve etj. Sipas parimeve të njohjes së ndërsjelltë, vendimet merren në një vend anëtar dhe njihen e zbatohen në të gjithë BE-në, mbështetur në prezumimin se të gjitha vendet anëtare të BE-së, kanë një sistem të mjaftueshëm të procedurës penale, duke përfshirë një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes të të drejtave themelore. Është e qartë që ky sistem presupozon një besim të ndërsjelltë. Mungesa e besimit midis vendeve anëtare në çdo sistem tjetër ligjor është një pikë kyçe dhe nuk lejon zbatimin e njohjes së ndërsjelltë në fushën e bashkëpunimit gjyqësor.

6. Urdhërat Evropiane për Arrest në fushën e bashkëpunimit gjyqësor

Vendimi Kuadër për Urdhërat Evropiane për Arrestime (UEA)⁵ janë ndoshta më të debatuarat, dhe në të njëjtë kohë instrumentat më të përdorur në legjislacionin penal Evropian, që sigurojnë një procedurë të thjeshtë dhe të shpejtë për dorëzimin e të dyshuarve dhe të dënuarve midis vendeve anëtare të BE-së. Numri i (UEA) të lëshuara është rritur përafërsisht nga 3000 në vitin 2004 në 13500 në vitin 2008. UEA është kuadri i parë ligjor që zbatohet në njohjen e ndërsjelltë në çështjet penale. Në preambulën e Vendimit Kuadër të UEA, përcaktohet respektimi i të drejtave të njeriut. Gjithsesi nuk parashikohet dhunimi (i mundshëm) i të drejtave. Një bazë tjetër për refuzim, në legjislacionin për ekstradimin e para-UEA është mosekstradimi i qytetarëve vendas. Ka shumë çështje interesante për

(vijon në faqen 12)

Zhvillimet Kushtetuese të Traktatit të Lisbonës në fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë në nivel mbikombëtar dhe kombëtar

(vijon nga faqja 11)

interpretimin e afateve të UEA, për shembull, kërkesat e dyfishta penale, bazuar në refuzimin e bashkëpunimit në krimet e mëparshme si në rastin Kozłowski, Wolzenburg, *Advocaten voor de Wereld* dhe Leymann⁶.

Në këtë kuadër, do të fokusohem në kërkesën paragjyqësore të ngritur për çështjen C-303/05 *Advocaten voor de Wereld*. Në vitin 2005, tri Gjykatat Kushtetuese të vendeve anëtare (Polonisë, Gjermanisë dhe Qipros), rishikuan dhe shpallën si jokushtetuese, aktet e tyre të brendshme, të cilat ishin në zbatim të vendimit të UEA. U bë e qartë se nëse Gjykatat vendase duan, mund të bllokojnë zbatimin praktik të shtyllës së tretë. Zyra avokatore “*Advocaten voor de Wereld*”, ngriti një padi në Gjykatën e Arbitrazhit⁶ Belgian Arbitragehof/Cour d’Arbitrage⁷, duke kërkuar anulimin e zbatimit të legjislacionit belg i cili transpozonte nenet e Direktivës Kuadër të UEA dhe procedurën e zbatuar midis vendeve. Gjykata belge iu drejtua Gjykatës së Drejtësisë për një opinion, lidhur me ligjshmërinë e Vendimit Kuadër.

Për sa i përket pretendimit të pare, se lënda e UEA duhet të ketë qenë e rregulluar nga Konventa, dhe jo nga Vendimi Kuadër, Gjykata në vendimin e datës 3 maj 2007, u shpreh se ish neni 34 i TBE nuk përcakton ndonjë lloj prioriteti midis instrumenteve të ndryshme të renditura në atë nen (qëndrime të përbashkëta, vendime kuadër, vendime, konventa) dhe se nuk mund të përjashtohet fakti se Këshilli i BE-së mund të zgjedhë midis instrumentave të ndryshëm për të rregulluar të njëjtën çështje.

Kërkesa e dytë paragjyqësore lidhej me thyerjen e parimeve të ligjshmërisë së krimit penal dhe dënimeve (nullum crimen, nulla poena sine lege) dhe mos diskriminimin.

Neni 2, paragrafi 2 i Vendimit Kuadër të UEA, përban një listë me 32 vepra kundravajtjesh, në zbatim të së cilës, parashikohen kushte të zakonshme të kriminalitetit të dyshishhtë nëse këto kundravajtje dënohen në shtetin që i jep këto dënime, nëpërmjet një dënimi ose një urdhër për paraburgim për një periudhë maksimale prej tri vitesh.

Gjykata respekton parimet e legjitimitetit të veprës penale dhe të dënimeve, të cilat parashikojnë se legjislacioni duhet të përcaktojë qartë veprat dhe dënimet. Ky kusht ndeshet në rastet ku personi i akuzuar, bazuar në nenin përkatës dhe me ndihmën asistencës shpjeguese të Gjykatës, ka të drejtën të njihet me veprën e kryer.

Gjykata, në vendimin e dhënë në datën 3 maj 2007, nuk gjeti arsye që të ndikonin tek vlefshmëria e Vendimit kuadër të UEA. Interesante janë vëzhgimet e bëra nga Avokati i Përgjithshëm Colomer për këtë rast:

“79. Gjykata duhet të njohë autoritetin e Kartës së Drejtave Themelore, si një mjet interpretativ për mbrojtjen e të drejtave themelore, të cilat janë pjesë e trashëgimisë së vendeve anëtare të BE-së. Kjo ndërmarrje duhet të qaset me kujdes, pasi mbrojtja e të drejtave themelore është një

pjesë thelbësore e shtyllës Komunitare, si dhe në kontekstin e shtyllës së tretë, e cila është e aftë të prekë thelbin e lirive individuale, atë të themelimit të lirive të tjera.

80. Në këtë mënyrë duhet të bëhet e mundur, shmangia e keqkuptimeve në të kaluarën, me gjykatat e vendeve anëtare, të cilat kanë qenë indiferente ndaj kapacitetit të Institucioneve Komunitare lidhur me mbrojtjen e të drejtave themelore.[...]”

Këto vëzhgime janë pak a shumë të zbatueshme që nga hyrja në fuqi e nenit 6 paragrafi 1 i Traktatit të Bashkimit Evropian të Traktatit të Lisbonës. Karta Themelore e të Drejtave të Njeriut do të ketë të njëjtat vlera si Traktatet. Standartet kombëtare të rishikimit mund të zëvendësohen nga standardet Evropiane dhe kjo mbrojtje nuk është pak e rëndësishme se ajo e dhënë nga kushtetutat kombëtare.

7. Pupino dhe detyrimi për interpretim

Në vitin 2001, BE-ja prezantoi Vendimin Kuadër, për pjesëmarrjen dhe dhënien e dëshmisë të të dëmtuarit gjatë procedurave gjyqësore⁸. Sipas nenit 8 të Vendimit Kuadër, vendeve anëtare të BE-së iu ishte kërkuar të siguronin, se nëse në çështjet veçanërisht më delikate, do të kishte nevojë për mbrojtjen e të dëmtuarve, në rastet e dhënies së dëshmive në një gjykim të hapur, atëherë ndaj këtyre personave, me vendim gjykate, mund të zbatohet në një mënyrë alternative e procedurës së zakonshme.

Kërkesa paragjyqësore u ngrit përpara një gjykate Italiane lidhur me çështjen nëse procedura e veçantë për hetim për një vepër seksuale duhet të shtrihet edhe ndaj fëmijëve viktime, si rezultat i parimit të efektit jo të drejtpërdrejtë, i përcaktuar me shtyllën e tretë. Interpretime të tilla mund të kërkojnë për shkak të detyrimit për të interpretuar legjislacionin vendas në përputhje me Vendimin Kuadër.

Për çështjen Pupino⁹, GJED u shpreh se detyrimi për “interpretimin e pajtueshëm” parashikohet në shtyllën e tretë. GJED deklaroi se ky vendim nuk mund të kishte efekt të drejtpërdrejtë. Gjithsesi nuk mund të përjashtohet efekti jo i drejtpërdrejtë.

Maria Pupino punonte edukatore në një çerdhe. Ajo ishte akuzuar se i kishte shkaktuar lëndime nxënësve nën 5 vjeç. Prokurori për këtë çështje i kërkoi Gjykatës Italiane të zbatojë një procedurë të veçantë hetimi, në të cilën do të merreshin në pyetje si dëshmitarë fëmijët, të cilët do të ekzaminoheshin në kushte të përshtatshme për ta. Sipas ligjit Italian, kjo nuk ishte e mundur. Gjithsesi, u bë e mundur falë interpretimit të Vendimit Kuadër, siç veproi GJED, në çështjen *Pupino*. Ky fenomen kushtetues i “interpretimit të pajtueshëm” është rezultat i Vendimit të dhënë në çështjen *Pupino*, ngriti pyetje të reja në fushën e të drejtës Evropiane, si çështja nëse e drejta e BE-së mund të ketë përparësi në raport me të drejtën e brendshme¹⁰. Disa komentatorë ishin

(vijon në faqen 13)

Zhvillimet Kushtetuese të Traktatit të Lisbonës në fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë në nivel mbikombëtar dhe kombëtar

(vijon nga faqja 12)

të mendimit se shtylla e tretë ishte më pak ndërqeveritare sesa ishte menduar.

GJED e interpretoi parimin e “interpretimit të pajtueshëm” si të mbështetur në parimin e bashkëpunimit në mirëbesim, dhe u shpreh se ai zbatohet në fushën e policisë dhe bashkëpunimit gjyqësor në çështjet kriminale.

8. Përfundime

Në këtë punim kam bërë një analizë të shkurtër të Traktatit të Lisbonës dhe të disa çështjeve të GJED. Çështjet lidhen me interpretimin e Vendimit Kuadër të shtyllës së tretë dhe ndikimin e tij në fushën e lirisë, sigurisë dhe të drejtësisë në rendin e brendshëm ligjor. Në këto vendime të GJED, të cilat janë dhënë përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, ishte parashikuar mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Gjithsesi një nga zhvillimet më të rëndësishme kushtetuese të Traktatit të Lisbonës, lidhur me çështjen tonë, është edhe hyrja në fuqi e nenit 6 të TBE, e cila parashikon se Karta Themelore e të Drejtave të Njeriut do të ketë të njëjtat efekte ashtu si dhe Traktatet. Për pasojë,

shumë vendime të GJED, janë dhënë përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, dhe këto nuk i reflektojnë zhvillimet e reja kushtetuese, si psh nevoja për të mbrojtur më shumë të drejtat e njeriut në fushat e policisë dhe bashkëpunimit gjyqësor dhe efektin e drejtpërdrejtë të Vendimit Kuadër.

Këto vendime tashmë mund t'i referohen neneve të Kartës Themelore të Bashkimit Evropian. Mbrojtja më e madhe e të drejtave të njeriut, duhet të jetë në fokus të punës të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, duke marrë parasysh edhe planifikimin për anëtarësim të BE në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe detyrimin për zbatim të Kartës Themelore të BE-së, miratuar me Traktatin e Lisbonës.

Përpara miratimit të Traktatit të Lisbonës, në çështjet e GJED dhe opinionet e Avokatit të Përgjithshëm, përmendet nevoja për mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe për miratimin e Kartës së Lirive Themelore. Garantimi i njëjtë i të drejtave dhe lirive themelore në nivel Evropian do të fuqizojë besimin e ndërsjellë midis vendeve anëtare. Një zhvillim tjetër i rëndësishëm kushtetues i fushës së lirisë, sigurisë dhe

* Hague, Gusht 8, 2011.

¹ J.W. de Zwaan/A.J. Bultena, Ruimte van Vrijheid, *Veiligheid en Rechtvaardigheid*, publikuar nga SDU 2002, fq. 78; Jaap W. de Zwaan, Flora Goudappel, *Freedom, Security and Justice in the European Union: Implementation of the Hague Programme 2004*, Cambridge University Press; Paul Craig, *The Lisbon Treaty, Law, Politics and Treaty Reform*, Chapter 9 - Freedom, Security and Justice, Oxford University Press, 2010 fq. 340.

² Çështje të përbashkëta C-402/05 P & C-415/05 P *Kadi & Al Barakaat kundër Këshillit të BE*, 3 C.M.L.R.41 (2008), [2008] ECR I-6351. Vendimi:

1. Ië mënjandë vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Komuniteteve Evropiane të 21 Shtatorit 2005 në çështjen Case T-315/01 *Kadi kundër Këshillit dhe Komisionit dhe çështjen T-306/01 Yusuf and Barakaat International Foundation kundër Këshillit dhe Komisionit*;

2. anulon Rregulloren e Këshillit (EC) No 881/2002 të 27 Maj 2002 që vendos masa specifike kufizuese ndaj disa personave dhe entiteteve që kanë të bëjnë me Usama bin Laden, rrjetin Al-Qaeda dhe Taliban, dhe shfuqizon rregulloren e Këshillit (EC) No 467/2001 që ndalon eksportin e disa mallrave dhe shërbimeve ndaj Afganistanit, duke fuqizuar ndalimin e fluturimeve dhe shtrirjen e ngrirjes së fondeve dhe burimeve të tjera financiare për Talibanin e Afghanistan;

³ Parashikon se efektet e rregullores nr 881/2002 duhet të ruhen, to be maintained, për aq sa lidhen me z. *Kadi dhe Al Barakaat International Foundation*, për një periudhë që nuk mund të shtrihet më shumë se tri muaj që nga data e shpërndarjes së këtij vendimi.

Shiko gjithashtu Paul Craig, Grainne de Burca, *EU Law, Text, Cases and Materials*, Fourth Edition, Oxford University Press, 2008, fq 191 dhe 290-292.

⁴ R. A. Wessel, *Kadi Case: Towards a More Substantive Hierarchy in International Law?*, in *International Organizations Law Review* 5 (2008) 323-327.

⁵ A. von Bogdandy, *Pluralism, Direct Effect, and the Ultimate say: On the Relationship between International and Domestic Constitutional Law*, in *International Journal of Constitutional Law*, 2008, Nos 3-4, 397-413, fq. 400.

⁶ Vendim Kuadër I Këshillit 2002/584/JHA i 13 Qershor 2002 për UEA dhe procedure e dorëzimit midis vendeve anëtare, OJL 19/1.

⁷ C-66/08 *Kozłowski* [2008] ECR I-6041; C-123/08 *Wolzenburg* [2009] ECR I-9621; C-388/08 *Leymann* [2008] ECR I-8993; C-303/05 *Advocaten voor de Wereld VZW*, Vendim i Gjykatës i 3 Maj 2007, [2007] ECR I-3633.

(vijon në faqen 14)

Zhvillimet Kushtetuese të Traktatit të Lisbonës në fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë në nivel mbikombëtar dhe kombëtar

(vijon nga faqja 13)

drejtësisë, në rendin e brendshëm ligjor, janë nenet e reja në Traktatin e Lisbonës nga neni 288-294 i TFBE lidhur me rregulloret, direktivat dhe vendimet. Ndaj tyre, do të zbatohet më shumë parimi i efektit të drejtpërdrejtë, sesa masat respektive, si qëndrimi i përbashkët, vendimi kuadër dhe konventat, bazuar në nenin 34 të Traktatit të Nicës. Neni 34 parashikon se Vendimet Kuadër dhe vendimet e tjera nuk do të kenë efekt të drejtpërdrejtë. Përderisa në Traktatin e Lisbonës, efekti i drejtpërdrejtë nuk është përjashtuar, ky përbën një ndryshim të rëndësishëm institucional. Neni 288 i TFBE, mund të jenë më efektiv, përderisa ai mund të ushtrojë zbatimin e parimit të supremacisë dhe të efektit të drejtpërdrejtë. Zhvillimi i tretë kushtetues, lidhet me faktin se Traktati i Lisbonës i ka sjellë të gjitha nenet që lidhen me fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë brenda një strukture “normale” e Traktatit “për Komunitetin”

Për pasojë, juridiksioni i GJED shtrihet në të gjitha aktet e BE-së. Traktati i Lisbonës solli një ndryshim madhor në lidhje me kufijtë e procedurave parapërgatitore dhe rishikimit të legjitimitetit në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Ato do të trajtohen pothuajse njëjloj, si çështjet e tjera të trajtuara në nenin 267 të TFBE, me përjashtime në fushat e policisë, dhe bashkëpunimit gjyqësor në çështjet kriminale.

Zhvillimi i katërt kushtetues është se Parlamentet

kombëtare kanë një rol më të rëndësishëm brenda pushtetit vendimmarrës në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, sesa përpara miratimit të Traktatit të Lisbonës, krahasuar me rolin e tyre në procesin vendimmarrës në fushën e tregut të brendshëm. Përfshirja e supremacisë në shtyllën e tretë ishte e nevojshme, për sigurimin e uniformitetit të zbatimit të legjislacionit të KE, si një kusht për vendosjen e tregut të brendshëm në lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit. Është pranuar se i njëjti arsyetim, nuk zbatohet në shtyllën e tretë për lëvizjen e lirë të personave¹¹. A nënkupton kjo se citimi që ka bërë K.Lenaerts sugjeron që i gjithë legjislacioni vendas që bie në kundërshtim me shtyllën e tretë të BE-së, nuk duhet marrë në konsideratë? Kjo lidhet me faktin se legjislacioni i shtyllës së tretë të BE-së është më i rëndësishëm se Kushtetutat e vendeve anëtare të BE-së? Përgjigja e pjesshme gjyqësore për këto pyetje është dhënë në çështjen C-303/05 *Advocaten voor de Wereld*. Standardet kombëtare të rishikimit mund të zëvendësohen nga standardet Evropiane. Qëndësia e njohjes së ndërsjelltë parashikohet në Traktatin e Lisbonës. Gjithsesi mungesa e besimit të ndërsjelltë dhe mungesa e masave mbrojtëse procedurale në nivel Evropian, janë aspekte që ndikojnë negativisht në forcimin e mëtejshëm policor dhe bashkëpunimin gjyqësor brenda BE-së. Gjithashtu ndjeshmëria e fushës është një pengesë për transferimin e më shumë pushteteve tek BE-ja.

Alfred KELLERMANN*

Përktheu:
Erjola Xhuvani

⁸ Aktualisht Gjykata Kushtetuese

⁹ C-105/03 *Criminal Proceedings against Maria Pupino* [2005] ECR I-5285

¹⁰ K.Lenaerts and T. Corthaut, *Of Birds and Hedges: the Role of Primacy in invoking Norms of EU Law* (2006) 31 EL Rev 287; J. H. Reestman and F. A. N. J. Goudappel, in *De Europese Unie na het Verdrag van Lissabon*, R.H.van Ooik and R.A. Wessel, Hoofdstuk 14 *Het Verdrag van Lissabon en de ruimte van vrijheid, veiligheid en recht*, fq. 175.

¹¹ S. Prechal, *Direct Effect, Indirect Effect, Supremacy and the Evolving Constitution of the European Union*, in C. Barnard, *The Fundamentals of EU Law Revisited* (Oxford University Press 2007), 35, 41.

Raport

për veprimtarinë e Komisionit të Integrimit European

Periudha mars 2012 –maj 2012

Historiku i shkurter i komisionit¹

Komisioni për Integrimin European ka një histori të shkurtër. Fillimi i kësaj strukture mund të konsiderohet vendimi i Kuvendit nr 37 datë 16.05.2002, “Për krijimin e Komisionit të Integrimit European dhe Paktit të Stabilitetit”. Bazuar në nenin 77 pika 1 të Kushtetutës, në të cilin thuhet se “Kuvendi zgjedh nga gjiri i saj komisione të përhershme si dhe mund të përcaktojë komisione të posaçme “ me vendimin e mësipërm u ngrit Komisioni *ad hoc* për Integrimin European dhe për paktin e Stabilitetit. Gjithashtu, për ngritjen e këtij komisioni, Kuvendi është bazuar edhe në rregulloren e tij si pasojë e detyrimeve që lindin nga zbatimi i procesit të integrimit european dhe Paktit të Stabilitetit dhe në veçanti hapja e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (neni 1 i vendimit)

Duke u bazuar në nenin 2 të po këtij vendimi, komisioni është ngritur me propozim të Komisionit të Jashtëm dhe sipas po këtij komisioni, në strukturën e re do të përfshiheshin përfaqësues të komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit

Qëllimet e këtij Komisioni ishin: (neni 3)

1. Nxitja e procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin European dhe zbatimi i paktit të stabilitetit;
2. Bashkërendimi ndërparlamentar i komisioneve të përhershme të Kuvendit për synimet e këtij Komisioni;
3. Koordinimi i politikave të Kuvendit, Këshillit të ministrave dhe të institucioneve të tjera të lidhura me MSA dhe me Paktin e Stabilitetit;
4. Përputhja e legjislacionit shqiptar me standardet dhe kërkesat e Bashkimit European;
5. Forcimi i bashkëpunimit midis Kuvendit të Shqipërisë, Parlamentit European, Asambleve Parlamentare të KE-së dhe të OSBE-së për të ndikuar në nxitjen dhe zbatimin të Paktit të Stabilitetit dhe të përshejtit të procesit të Stabilizim Asociimit;
6. Krijimin e bërthamave parlamentare për parandalimin e konflikteve në rajon dhe shkëmbimin e informacioneve ndërmjet parlamenteve;
7. Forcimi i bashkëpunimit me parlamentet e rajonit, shkëmbimi i përvojave në procesin e Stabilizim Asociimit;
8. Plotesimi i kushteve dhe detyrimeve për hapjen e negociatave të MSA në fushën politike, ekonomike, të drejtësisë dhe të mejdisit;
9. Transparenca ndaj opinionit publik si dhe

bashkëpunimi me shoqërinë civile në zbatimin e procesit të integrimit european dhe të paktit të stabilitetit;

10. Organizimi i debateve parlamentare për rëndësinë e luftës kundër krimit të organizuar dhe të trafikut njerëzor, me qëllim mbajtjen e këtij problemi vazhdimish në axhendën politike kombëtare;

11. Informimi i Kuvendit me politikat e demokracisë, sigurisë e të zhvillimit ekonomik në kuadër të paktit të stabilitetit dhe iniciativave të tjera rajonale, si SEECEI, SEECP, Adriatiko-joniane etj.

Me miratimin e Rregullores² së re me vendim të Kuvendit, Komisioni Parlamentar për Integrimin European renditet i dyti në listen e tetë komisioneve të përhershme. Ky vendim i jep Komisionit një rendësi të veçantë, duke i përcaktuar edhe fushën e kompetencave të tij, e cila është *integrimi në Bashkimin European*³. Në relacion me komisionin e mëparshëm, është e nevojshme të konstatohet se, së pari, Komisioni me rregulloren e re është komision i përhershëm dhe jo më i përkohshëm dhe, së dyti, si rrjedhojë e përhershmerisë së tij, ai merr një aspekt vazhdimësie. Në këtë mënyrë, edhe Parlamenti është një tregues që integrimi european është një proces që ndërtohet dita-ditës. Kjo legjislaturë është e treta që Komisioni i Integrimit po përballlet me integrimin european në mënyrë të vazhdueshme, natyrisht edhe duke marrë eksperiencë të çmuar edhe nga parlamentet e tjera. Gjithashtu, duke e konsideruar Shqipërinë si vend potencial kandidat, komisioni i integrimit european ka tashmë një eksperiencë të konsoliduar në këtë dhe puna e tij është gjithnjë e në rritje. Pas ratifikimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), Komisioni ka hyrë në një fazë të re të procesit të integrimit european dhe të rëndësishme sepse në fazën aktuale dhe në atë të kandidatit, Shqipëria jo vetëm duhet të tregojë një vullnet politik për rrugën e saj drejt Bashkimit European, por edhe zbatimin e standarteve të cilat janë rrjedhojë direkte pas hyrjes në fuqi të MSA.

Kompetencat e këtij komisioni, duke u bazuar në rregulloren e Kuvendit, janë: shqyrtimi i projektligjeve dhe përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit European; monitorimi i qeverisë dhe i politikave në zbatim të ligjeve të përafuara për rritjen e standardeve europiane në Shqipëri, si dhe funksioni zgjedhor.

(vijon në faqen 16)

¹ Informacioni është marrë pranë Komisionit të Integrimit European dhe është bazuar në statistikat, në raportet dhe në procesverbalet e komisionit.

² Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë e miratuar me vendim nr. 166, datë 16.12.2004 dhe e modifikuar me Vendim nr. 193, datë 07.07.2008, Vendim nr. 15, datë 27.12.2005, Vendim nr. 21, datë 04.03.2010, Vendim nr. 41, datë 24.06.2010, Vendim nr. 88 datë 24.02.2011, Vendim 89, datë 24.02.2011

³ Neni 19 i rregullores së Kuvendit

Raport

për veprimtarinë e Komisionit të Integrimit European

Periudha mars 2012 –maj 2012

(vijon nga faqja 15)

Funksioni ligjvënës

Aktiviteti i komisioni bazohet kryesisht në kalendarin e Kuvendit të Shqipërisë si dhe në Programin e punës së tij. Bazuar në këto dy dokumente, Komisioni për Integrimit European, gjatë periudhës **mars 2012 –maj 2012** ka zhvilluar disa mbledhje për shqyrtimin e projekligjeve për të cilin ka qënë komision për dhënie mendimi në lidhje me përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit European.

Mars

Gjatë muajit mars komisioni ka shqyrtuar **2** projektligje:

- **Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, të ndryshuar”**

Qëllimi i këtij projektligji është tejkalimi i një handicap-i ligjor vetëm për një saktësim më të mirë për sa i përket çështjes së varësisë, sepse Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar që në krijimin e tij në vitin 2001 është varur nga Kryeministri për vetë specifikën që ka, gjithashtu detyrat burojnë nga Kryeministri dhe jo sikurse përkruhet në ligjin e vjetër nga Këshilli i Ministrave.

Në mbledhjen e Komisionit për të mbrojtur projektligjin u paraqitën përfaqësues nga Drejtoria Juridike dhe Mbikëqyrjes Shtetërore në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar në Këshillin e Ministrave, Sektori Juridik dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar në Këshillin e Ministrave, si dhe ekspert nga Drejtorinë e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme në Ministrinë e Integrimit European.

Në këtë projektligj nuk është parashikuar përputhshmëri me legjislacionin european.

- **Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare “Për sistemin e harmonizuar të kodimit dhe përshkrimit të mallrave””.**

Qëllimi i këtij projektligji është që nëpërmjet aderimit në këtë marrëveshje, të sigurohet zbatimi i punës së bërë nga Komiteti i Sistemit të Harmonizuar, të ngritur nga Këshilli i Bashkëpunimit Doganor si dhe harmonizimi i të dhënave të sakta dhe të krahasueshme për qëllimet e tregtisë ndërkombëtare. Gjithashtu kjo marrëveshje ka si qëllim përdorimin e sistemit të harmonizuar për qëllimet e tarifave të mallrave dhe të statistikave të llojeve të ndryshme të transportit dhe eksportit të statistikave prodhuese; përditësimin e sistemit të harmonizuar më ndryshimet e teknologjise apo modelet e tregtisë ndërkombëtare; lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare, përmirësimin në

mbledhjen, krahasimin dhe analizën e statistikave në vecanti ato për tregtinë ndërkombëtare dhe rikodifikimin e mallrave kur ato lëvizin nga një sitem klasifikimi në një tjetër në rrjedhën e tregtisë ndërkombëtare dhe në lehtësimin dhe standatizimin e dokumentacionit dhe trasmetimit të të dhënave.

Kjo marrëveshje vjen në respektim të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Në mbledhjen e Komisionit për të mbrojtur projektligjin u paraqitën përfaqësues të Drejtorisë së Tarifave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave si dhe përfaqësues nga Ministria e Integrimit European, një përgjegjëse sektori dhe një specialist.

Në këtë projektligj nuk është parashikuar përputhshmëri me legjislacionin european.

Prill

Gjatë muajit prill komisioni i integrimit european ka shqyrtuar **4** projektligje.

- **Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale.”**

Qëllimi i këtij projektligji është disiplinimi i veprimtarisë së punës së kontrolluesve në marrëdhëniet e tyre me Komisionerin për Mbrojtjen e të dhënave personale përsa i përket zbatimit të vendimeve, rekomandimeve si dhe bashkpunimit për të shkëmbyer informacione. Projektligji forcon pozitën e komisionerit në cilësinë e institucionit të pavarur duke pasur në themel të punës të drejtat dhe liritë e individit dhe privatësinë e tij

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishin të pranishëm përfaqësues të specialist nga Drejtoria e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme në Ministrinë e Integrimit, specialiste nga Drejtoria e Çështjeve Procedurale Ligjore të Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, specialiste për mbrojtjen e të dhënave në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, përgjegjës sektori të Akteve në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Brendshme. si dhe një këshilltar i ministrit për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit.

Duke parë rëndësinë e këtij ligji dhe duke konsideruar gjithashtu se edhe vetë Bashkimi European është në fazë rishqyrtimit të normave të Bashkimit European në lidhje me të dhënat personale, ky projektligj u shqyrtua në dy mbledhje duke patur gjithashtu të ftuar edhe vetë komisioneren për të dhënat personale si dhe specialist nga projekti ndihmës për hartimin e projektligjit. Gjithashtu në mbledhjen e dytë ishte i pranishëm edhe zëvendësministri i Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.

(vijon në faqen 17)

Raport

për veprimtarinë e Komisionit të Integrimit European

Periudha mars 2012 –maj 2012

(vijon nga faqja 16)

Në respekt të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, projektligji përafrohet plotësisht me direktivën 95/46/KE të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 24 tetor 1995 “Mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave.

· Projektligji “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”.

Qëllimi i këtij projektligji, sipas nenit 1 të tij, është përcaktimi i rregullave, kriterëve dhe kushteve për themelimin dhe administrimin e shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, të drejtat dhe detyrimet e themeluesve e të anëtarëve të tyre, riorganizimin dhe prishjen e tyre, si dhe rregullimin e vendosjen e kriterëve për disa aspekte të aktivitetit të tyre.

Për paraqitjen e këtij projektligji në mbledhje ishin të pranishëm një zëvendësministër nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dy drejtorë të Përgjithshëm, i Politikave Bujqësore dhe i drejtorisë Juridike në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit si dhe një specialiste për kooperimin në Drejtorinë e Këshillimit në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Në respekt të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, projektligji përafrohet pjesërisht me rregulloren e Këshillit 1435/2003/KE, datë 2 Korrik 2001, “Mbi Statutin e shoqërive Europiane të Kooperativave”.

· Projektligji “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”.

Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i rregullave të përgjithshme për prodhimin, mbajtjen, magazinimin, lëvizjen dhe kontrollin mbi produktet që i nënshtrohen detyrimeve të akcizës, si dhe vendosjes së rregullave specifike mbi akcizën që të zbatohet mbi konsumin e produkteve energjetike, alkoholin dhe pijet alkolike, duhanin dhe nnpduktet e tij.

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Financave, një drejtor, përfaqësues të Ministrisë së Integrimit European, një përgjegjës sektori, si dhe përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, dy drejtorë drejtorie

Në respekt të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, projektligji përafrohet pjesërisht me direktivën e Këshillit 2008/118/KE, datë 16 dhjetor 2008 “Lidhur me masat e përgjithshme mbi taksën e akcizës, e cila shfuqizon direktivën 92/12/KE, rregulloren e Këshillit 450/2008, datë 23 prill 2008 “Mbi kodin e modernizuar doganor”, direktivën e Këshillit 2003/96/KE, datë 27 tetor 2003, “Mbi strukturimin e kornizës së Komunitetit për taksimin e produkteve energjetike ose elektrike”, direktivën e Këshillit 92/84/KEE, datë 19 tetor 1992, “Mbi harmonizimin e strukturës së akcizës së alkoolit dhe pijeve alkolike” si dhe me vendimin e Komisionit 2006/

428, datë 22 qershor 2006, “Mbi përcaktimin e një pulle të përbashkët fiskale për hidrokarburet dhe kerosene”.

· Projektligji “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

Qëllimi i këtij projektligji, sipas nenit 1 të tij, është përcaktimi i parimeve bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar, garantimi i të drejtës për arsimim nëpërmjet përcaktimit të një kuadri ligjor për funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar.

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, një zëvendësministër dhe dy përgjegjës sektori.

Në respekt të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, projektligji përafrohet plotësisht me Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit European (2000/C 364/01), datë 18 dhjetor 2000, me Traktatin Mbi funksionimin e BE, neni 165 (ish neni 49) “Edukimi, trainimi profesional, rinia dhe sportet”, si dhe me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit Shqipëri BE, neni 100, “Arsimi dhe trainimi”.

Maj

Gjatë muajit maj Komisioni i Integrimit European ka shqyrtuar 1 projektligj.

· Projektligji “Për peshkimin”.

Referuar Neni 1 të këtij projektligji, objekti i tij është rregullimi i veprimtarisë së peshkimit dhe menaxhimi duke siguruar mbrojtjen e gjallesave detare dhe të ujërave të brendshme nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të qendrueshëm në aktivitetin në det dhe në ujrat e brendshme.

Në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar Projektligjin “Për peshkimin”, u paraqitën përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave si dhe përfaqësues të Ministrisë së Integrimit.

Në respekt të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, projektligji përafrohet pjesërisht me rregulloren e Këshillit Nr. 1224/2009/KEE, datë 20 Nëntor 2009 “Mbi krijimin e një sistemi kontrolli komunitar për të garantuar respektimin e rregullave të politikës së përbashkët të peshkimit”, e cila ndryshon Rregulloret Nr. 847/96/KE, Nr. 2371/2002/KE, Nr. 811/2004/KE, Nr. 768/2005/KE, Nr. 2115/2005/KE, Nr. 2166/2005/KE, Nr. 388/2006/KE, Nr. 509/2007/KE, Nr. 676/2007/KE), Nr.1098/2007/KE, Nr.1300/2008/KE, Nr.1342/2008/KE dhe shfuqizon Rregulloret Nr. 2847/93/KEE, Nr. 1627/94/KE dhe Nr. 1966/2006/KE; direktivën e Parlamentit European dhe Këshillit Nr. 2000/60/KE, datë 23 Tetor 2000 “Mbi krijimin e një kuadri për veprimin komunitar në fushën e ujërave” e ndryshuar.

Rregulloren e Këshillit Nr. 2371/2002/KE, datë 20 Dhjetor 2002 “Mbi mbrojtjen dhe shfrytëzimin e

(vijon në faqen 18)

Raport

për veprimtarinë e Komisionit të Integritimit Europian

Periudha mars 2012 –maj 2012

(vijon nga faqja 17)

qëndrueshëm të burimeve peshkore në kuadër të politikës së përbashkët të peshkimit” e ndryshuar

Rregulloren e Këshillit Nr. 1967/2006/KE, datë 21 Dhjetor 2006 “Mbi masat menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore të Detit Mesdhe”, e cila ndryshon Rregulloren Nr. 2847/93/KEE dhe shfuqizon Rregulloren Nr. 1626/94/KEE”; rregulloren e Këshillit Nr. 1198/2006/KE, datë 27 Korrik 2006 “Mbi Fondin Europian të Peshkimit”, rregulloren e Këshillit Nr. 1005/2008/KE, datë 29 Shtator 2008 “Mbi krijimin e një regjimi komunitar për të parandaluar, dekurajuar dhe eliminuar peshkimin ilegal, të padeklaruar dhe të parregulluar”, e cila ndryshon Rregulloret Nr. 2847/93/KE, Nr. 1936/2001/KE, Nr. 601/2004/KE dhe shfuqizon Rregulloret, Nr. 1093/94/KE e (KE) Nr. 1447/1999; rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 199/2008 e 25 shkurtit 2008 “Mbi krijimin e një kuadri komunitar për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen e këshillimit shkencor në lidhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit; rregulloren e Këshillit Nr. 104/2000/KE, datë 17 Dhjetor 1999 “Mbi organizimin e përbashkët të tregjeve për produktet e peshkimit dhe akuakulturës”; vendimin e Komisionit Nr. 1999/478/KE, datë 14 Korrik 1999 “Për rinovimin e Komitetit Konsultativ për Peshkimin dhe Akuakulturën”; vendimin e Komisionit Nr. 2005/629/EC, datë 26 Gusht 2005 “Për krijimin e Komitetit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik për Peshkimin”

Rregulloren e Zbatimit e Komisionit Nr. 404/2011/BE, datë 8 Prill 2011 “Për përcaktimin e modaliteteve të zbatimit të Rregullores së Këshillit Nr 1224/2009/KEE, datë 20

Nëntor 2009 “Mbi krijimin e një sistemi kontrolli komunitar për të garantuar respektimin e rregullave të Politikës së Përbashkët të Peshkimit”

Funksioni mbikqyrës

Mars

Komisioni i Integritimit Europian ka zhvilluar dy seanca dëgjimore me znj. Bregu, Ministre për Integritimin Europian mbi 12 rekomandimet e Komisionit Europian.

Në takime ka qënë i pranishëm edhe një përfaqësues i Bashkimit Europian.

Këto takime janë monitoruar edhe nga një përfaqësues i shoqërisë civile.

Prill

Komisioni për Integritimin Europian nuk ka zhvilluar seancë dëgjimore.

Maj

Komisioni për Integritimin Europian nuk ka zhvilluar seancë dëgjimore

Funksioni zgjedhor

Deri në këto momente komisioni për integritimin europian nuk e ka ushtruar këtë funksion.

Denis Gila

Këshilltar në Komisionin Parlamentar të IE

Debati Intelektual mbi Deficitin Demokratik në Bashkimin Europian¹

Hyrje

Debati intelektual mbi ‘deficitin demokratik’ në Bashkimin Europian (BE) u iniciua për herë të parë në vitin 1979, nga politologu Britanik, David Marquand. Në librin e tij, *Parlament për Europën*, Marquand vuri theksin në dobësinë e komponentëve demokratikë në institucionet e atëhershëm të komunitetit Europian duke kritikuar deficitin e demokracisë Europiane si të papranueshëm për një komunitet i cili ishte bazuar dhe angazhuar për të promovuar parimet demokratike. Këto kritika vinin fill pas një periudhe stanjacioni integrimi evropian, apo njohur ndryshe si Euroskleroza e viteve ’50-’70, ku mbizotëronte perceptimi se Komuniteti Europian kishte mungesë demokracie, ritëm të ngadaltë integrimi dhe zgjerimi si dhe probleme ekonomike. Që nga ajo kohë debati mbi deficitin demokratik në BE u bë një temë tepër e frekuentuar diskutimi e cila lidhet me shumë shqetësime konkrete të cilat kanë të bëjnë me të ardhmen e BE-së dhe procesit të integritimit.² Ndaj shpeshherë ky debat ka qënë lehtësisht i manipulueshëm

nga euroskeptikët apo të gjithë ata të cilët nuk janë plotësisht të kënaqur me funksionimin e institucioneve Europiane.³

Pavarësisht studimeve të shumta dhe përfshirjes së shumë akademikëve dhe politikanëve në debatin e tej-zgatur rreth deficitit demokratik në BE, akoma nuk ka një konsensus, jo thjesht për faktin në ka apo jo një deficit demokratik në BE, por më tepër rreth asaj se çfarë kuptojmë dhe diskutojmë kur flasim dhe argumentojmë për deficitin demokratik në BE. Një kuptim i vetëm i deficitit demokratik nuk ekziston.⁴

Gjithsesi, një studim i hollësishëm dhe sistemim i literaturës tregon tre elementë kryesorë të debatit (shih Jano 2008). Dy elementët e parë kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me dy dimensionet kryesore të demokracisë, dimensionin institucional dhe atë socio-kulturor. Në përpjekjen e tij për të ofruar një kuptim sa më të plotë rreth debatit mbi deficitin demokratik, Meny bën një dallim të dobishëm ndërmjet dy

(vijon në faqen 19)

Debati Intelektual mbi Deficitin Demokratik në Bashkimin Europian

(vijon nga faqja 18)

shtyllave themelore të demokracisë, nga një anë 'populli' dhe nga ana tjetër 'kontrolli-dhe-balancimi', duke argumentuar se të gjitha demokracitë e sotme janë të përbëra nga një përzierje elementesh popullore dhe konstitucionaliste (Mény, 2003, f.3). Kjo ndarje midis dy elementeve kryesore të demokracisë është padyshim një mjet i dobishëm analitik, pasi debati rreth deficitit demokratik është përqendruar kryesisht në argumentin kryesor të mungesës së një 'populli europian' dhe/ose të mangësive në rregullimin e pushteteve institucionale.⁵ Veç kësaj ndarjeje midis elementeve kryesore të konceptit të demokracisë, ekziston edhe një element tjetër dallues i literaturës, i cili është specifik dhe i aplikueshëm vetëm në kontekstin tepër të veçantë të Bashkimit Europian. Ky element ka të bëjë me vetë objeksionin se çfarë entiteti politik është BE-ja, si mund ta përkufizojmë dhe studiojmë atë. Pra në argumentimin nëse ka deficit demokratik apo jo, së pari duhet të marrim parasysh nëse studiuesit e konceptojnë BE-në si shtet, si organizatë ndërkombëtare apo si një entitet politik *sui generis*.

Duke evidentuar këto tre linja do të përpiqemi të sjellim debatin akademik dhe politik mbi deficitin demokratik në BE në një formë jo vetëm të thjeshtëzuar dhe të përmbledhur, por edhe të mirë-sistemuar. Në analizën në vijim do të fokusohemi dhe do të trajtojmë të trija këto elemente të literaturës, duke sjellë argumentet kryesore pro dhe kundër të një deficitit demokratik të BE-së.

Argumentet Institucionaliste

Argumentet institucionaliste të debatit fokusohen veçanërisht në (mos)dobësinë e strukturës dhe/ose funksioneve të institucioneve të BE-së. Struktura e institucioneve të BE-së dhe mënyra se si ato funksionojë shpesh herë kanë ngritur dyshime në lidhje me transparencën, përgjegjshmërinë dhe legjitimitetin e vetë BE-së.

Diskutimet rreth *strukturës* së institucioneve të BE-së i referohet balancës së pushteteve midis Komisionit, Këshillit dhe Parlamentit Europian. Pyetja e përgjithshme është nëse konfigurimi i të tre institucioneve politike të BE-së lë hapësirë të mjaftueshme për 'tu dëgjuar zëri i qytetarëve' pasi demokracitë janë, mbi të gjitha, shprehje e vullnetit dhe zgjedhjes popullore. Studiuesit të cilët mbështesin konfigurimin aktual të BE-së argumentojnë se të gjitha institucionet e BE-së janë nën kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë demokratik.⁶ Vullneti i popujve mund dhe është shprehur, në mënyrë të tërthortë dhe fuqishëm nëpërmjet ekzekutiveve kombëtare të Këshillit të Ministrave, dhe direkt, ndonëse shumë më i dobët, nëpërmjet anëtarëve të Parlamentit Europian të zgjedhur direkt nga qytetarët europianë (Schmidt, 2009, f. 983) apo së fundmi me ndryshimet e traktatit të Lisbonës, nëpërmjet demokracisë direkt të iniciativës qytetare. Në përgjithësi, çështja më e diskutuar ka qenë nëse Parlamentin Europian duhet të

merre një rol më të madh? Deficiti i strukturës institucionale të BE-së i referohej pushtetit të *pjesshëm* të Parlamentit Europian në vendim-marrjen legjislativë ku pavarësisht procedurave të shumta Parlamenti Europian merre pjesë vetëm në disa prej tyre dhe nuk ishte ligjvënësi vendimtar, për shembull përmendim këtu procedurën e konsultimit.⁷ Disa studiues argumentojnë se pushteti i kufizuar i Parlamentit Europian për të nxjerrë ligje dhe për të kontrolluar pushtetin ekzekutiv të Komisionit dhe të Këshillit të Ministrave të BE-së krijonte një mungesë përgjegjësie elektorale (Bellamy, 2006, f. 725). Me traktatin e Lisbonës dhe vendosjen e procedurës së bashkë-vendimmarrjes si procedurë normale iu dha Parlamentit një rol dhe pushtet më i madh legjislativ, të barasvlershëm me atë të Këshillit Europian të Ministrave.

Të tjerë studiues, pranojnë se problemi i deficitit demokratik nuk qëndron në ndërtimin institucional sesa më tepër në *funksionimin* e institucioneve të BE-së.⁸ Këto argumente fokusohen më shumë në aspektet procedurale të institucioneve të BE-së, të cilat mbartin një numër problematikash. Shumë studiues kanë vënë në dukje se institucionet e BE-së, sidomos Këshilli i Ministrave, karakterizohen nga një 'fshetësi' e tepërt.⁹ Mungesa e transparencës në procesin e vendimmarrjes apo delegimi i tepruar në procesin legjislativ ka qenë një kritikë e fortë në favor të argumentit të një deficitit demokratik në BE (Crombez, 2003, f.101). Kompleksiteti i vendim-marrjes dhe distanca e publikut janë argumentet të cilat minimalisht dobësojnë potencialin e një demokracie me bazë të gjerë.

Por në një kritikë më substanciale qëndron legjitimiteti i BE-së, i cili inspirohet nga një mungesë e theksuar besimi tek përfaqësimi dhe efektiviteti i institucioneve të BE-së. BE-ja e ka humbur legjitimitetin e saj jo vetëm nga mungesa e institucioneve më demokratike¹⁰ por kryesisht edhe për shkak të dështimit të saj për të siguruar drejtësi sociale.¹¹

Argumentet Social-kulturore

Faktorët social-kulturorë janë një tjetër dimension i debatit rreth deficitit demokratik, përveç dimensionit institucional. Shtjellimi i dimensionit social-kulturor trajton që nga elementët më të thjeshtë të kohezionit social-kulturor e deri tek ato më komplekse. Një qasje të tillë e vë theksin kryesisht në argumentin e mungesës të një 'populli', të një sfere publike apo të një komunitet-ndërtimi Europian.¹² Kjo literaturë i mëshon idesë se BE-ja nuk funksionon mirë si një demokraci për shkak se nuk ka një opinion publik europian, nuk ka një elektorat europian dhe nuk ka një popull europian (shih Crombez, 2003, f. 105 dhe Bellamy, 2006, f. 725).

Demo-cracy si term në vetvete nënkupton praninë e një populli (*demos*), në të kundërt termi do të ishte i pakuptimtë. Supozimet e mungesës, - e për më tepër pamundësisë potenciale të një populli europian pasi populli nuk është një e dhënë por një konstrukt i ndërtuar

(vijon në faqen 20)

Debati Intelektual mbi Deficitin Demokratik në Bashkimin Europian

(vijon nga faqja 19)

historikisht, (Zweifel, 2002, f. 819) - është një fakt i mjaftueshëm për të argumentuar deficitin demokratik në BE. Në mungesë të një populli, pra të njerëzve të cilët nuk i përkasin një komuniteti politik të konstituar, nuk mund të ketë as 'sovrانيت demokratik'¹³ dhe as një 'legjitimitet demokratik'¹⁴. Këto argumente janë kritikuar gjerësisht si tradicionale dhe populiste, duke evidentuar kështu komponentë të rinj, më liberale të cilët duhet ti kemi parasysh kur vlerësojmë nëse ekziston apo jo një deficit demokratik në BE (Meny, 2003, f. 11).

Në argumente më të sofistikuara, çështja e popullit është e lidhur me marrëdhëniet midis qytetarëve dhe institucioneve të BE-së pasi që 'një problem i madh është mungesa e një lidhje midis politikës demokratike në rritje brenda Parlamentit Europian dhe Këshillit të BE-së dhe pikëpamjeve të publikut' (Føllesdal dhe Hix, 2006, f. 553). Ajo që supozohet është se publiku ka ndikim dhe përfshirje shumë të vogël në procesin e vendimmarrjes duke krijuar kështu një besim të pamjaftueshëm në institucionet e BE (Zweifel, 2002, f. 818). Ky mosbesim është vërejtur në një rënie graduale të pjesëmarrjes në zgjedhjet euro-parlamentare' (Cohen dhe Sabel, 2003, f. 697), si dhe në pakënaqësinë e shprehur në sondazhet e Eurobarometerit (Offe dhe Preuss, 2006).

Një variant i dytë alternativ i dimensionit social-kulturor të debatit mbi deficitin demokratik refuzon të flasë për popull, por preferohet më tepër që të argumentohet me një ide më ambicioze të demokracisë, atë të 'polit-formimit' në entitetin politik të BE-së. Ky vizion i ri është i bazuar, jo tek homogjeniteti por tek ideja e solidaritetit, bazuar në njohjen e ndërsjellët të tjetrit (Offe dhe Preuss, 2006, f. 31). Kjo presupozon që 'politi' BE ka arritur një shkallë të konsiderueshme të pjekurisë si një sistem politik i cili mund të ushtrojë funksionet 'klasike' të sistemeve politike, (të tilla si prodhimi i politikave publike) me politikën rregullatore si shtyllën kryesore të aktivitetit politik të BE-së.¹⁵ Por pyetja që lind këtu është nëse ne mund të flasim për një 'politi' pa patur një hapësirë publike koherente dhe në mungesë të komunitet-formimit.

Pavarësisht opinionit të pranuar gjerësisht për ekzistencën e një sferë publike europiane në zhvillim, kjo është parë me skepticizëm pasi është më shumë një përbërje 'publik-ësh' të shteteve-anëtare sesa një publik i vetëm europian.¹⁶ BE krahas angazhimeve zyrtare në zgjedhjet euro-parlamentare nuk ka shkuar më tej për të ndërtuar një 'polit' europian. BE-ja nuk ka inkurajuar, përtej formaliteteve të zgjedhjeve euro-parlamentare, krijimin e një sferë publike europiane të angazhuar në debatet rreth të ardhmes të një 'politi' Europian (Cohen dhe Sabel, 2003, f. 697). Në një Europë e cili po zgjerohet gjithnjë e më tepër mund të evidentohet lehtësisht një përbërje heterogjene publike e hapësirës europiane dhe jo një 'polit' kompakt. Problemi që lind këtu është se ky 'polit' divergjent ka pak

mundësi për t'u angazhuar në çështjet e BE-së dhe nga ana tjetër BE-ja ka shumë pak mundësi që të komunikojë drejtpërdrejt me qytetarët e saj.

Argumente më të përparuara diskutojnë për një mungesë afrimiteti me BE-në. Vërehet se qytetarëve të BE-së u mungon ndjesia e përkatësisë në një komunitet të vetëm.¹⁷ Føllesdal¹⁸ argumenton se rregullimet e brendshme demokratike të tanishme (pra të drejta politike dhe shtetësia europiane) janë të pamjaftueshme. Ai gjithashtu konstaton se Europianët ndajnë vlera dhe përkatësi të përciptë dhe të përgjithshme të cilat jo domosdoshmërisht mund të ndërtojnë një komunitet. Argumenti mbi shmangien e një deficitit komunitar – pra rritja e vlerave dhe lidhjeve të përbashkëta – do të theksohet nga Etzioni (2007) si një faktor i rëndësishëm i cili do të kontribuojnë në një BE më demokratik dhe të qëndrueshëm. Është e nevojshme për të investuar në dimensionin qytetar të komunitet-formimit duke i dhënë kështu rëndësi 'ndjesisë-ne' dhe argumentit 'komunitet', në mënyrë që t'i japin individëve një arsye për t'u kujdesur për politikën e BE-së.¹⁹ Ekzistenca e një niveli minimal të 'ndjesisë-ne' duket e rëndësishme pasi që qytetarët me një lloj vlerash të përbashkëta dhe lidhesh sentimentale do ti japin më shumë substancë dhe vlefshmëri BE-së.

Kontekstualiteti dhe Konceptimi i BE-së

Argumentet dhe kundër-argumentet e përdorur në debatin rreth deficitit demokratik janë kontekstuale dhe reflektojnë mënyrën sesi akademikët e konceptualizojnë BE-së si dhe mungesën e konsensusit rreth një njësie politik e krahasueshme me modelin e BE-së. Debati akademike mbi atë çka është vetë BE-ja është ende i hapur pasi nuk ka një konsensus akademik rreth ontologjisë së BE-së²⁰ i cili do të na ndihmonte për të kuptuar karakterin e vërtetë politik të saj. Në këto kushte, çdo analizë rreth çështjeve të cilat lidhen me BE-në, reflektojnë presupozimin fillestar nëse BE-ja është konceptualizuar si një entitet politik i cili i përngjan një shteti, një organizate ndërkombëtare, apo është një entitet më vete i pa krahasueshëm. BE-ja duke qenë një objekt politik konceptualish i diskutuar ka lënë hapësira zgjedhjeje në mënyrën e qasjes të studiuesve. Kjo në vetvete është një arsye për tu konsideruar. Përpara se të vlerësojmë çdo argument rreth deficitit demokratik duhet, pikë së pari të identifikojmë se në çfarë niveli krahasimor studiuesit janë duke ngritur argumentet e tyre.

Argumentet e debatit, qëndrojnë në tre nivele analizimi të ndryshme, përkatësisht atë të modelit-shtetit, modelit-organizatë-kombëtare dhe qasjes *sui generis*. Për Moravcsik BE-ja është thjesht një organizatë ndërkombëtare dhe ai e analizon BE-në dhe deficitin demokratik në këtë këndvështrim. Ndërsa Majone për analogji sjell argumente të një qasje me analogji të modeli-shtet.²¹ Føllesdal dhe Hix (2006) në reagimin e tyre ndaj Majones dhe Moravcsik, kanë ngritur shqetësimet rreth nivelit të analizimit, duke

(vijon në faqen 21)

Debati Intelktual mbi Deficitin Demokratik në Bashkimin Europian

(vijon nga faqja 20)

argumentuar se pikëpamjet e Majones rreth deficitit demokratik në BE janë zgjerime logjike të teorisë së tij të 'politikës rregullatore' të BE-së, ndërsa opinionet e Moravcsik janë zgjerime të teorisë së tij liberal-ndërqeveritare. Nga ana tjetër, kritika kryesore e Zielonka përkundrejt argumenteve të Føllesdal dhe Hix qëndrojnë përsëri te niveli i analizimit duke kritikuar qasjen e tyre për të aplikuar modelin demokratik të shtetit në një entitet i cili nuk është shtet.²² Zielonka vetë preferon të marrë një qëndrim *sui generis* ku Bashkimi Europian analizohet si një prototip i qeverisjes post-moderniste, shumë-nivelesh dhe policentrike e cila është e decentralizuar, fleksibël, deliberative, joformale, përfshirëse dhe jo-territoriale (Zielonka, 2007, f. 187). Por niveli i analizës *sui generis* nuk është jo-problematik. Siç edhe argumenton Zweifel qasja ndaj BE-së si *sui generis* ka mangësinë e trajtimit të BE-së në një vakum në të cilin nuk mund ta krahasojmë me entitete të tjera politike, (Zweifel 2002, f. 812) duke e sjellë analizën edhe njëherë në nivelin e modelit-shtet, për të na kthyer aty ky e filluam me argumentet e Majones dh të Moravcsik. Kjo e bën debatin ciklik, ku gjithsecili sjell kundër-argumente të cilat më shumë se argumente të drejtpërdrejta rreth deficitit demokratik janë oponencë ndaj përzgjedhjes së nivelit të analizës dhe krahasimit të BE-së si model-shtet, *sui generis* apo model-organizatë ndërkombëtare.

Përzgjedhja e studiuesve në mënyrën sesi e konceptojnë BE dhe me çfarë modeli demokratik e krahasojnë atë është debati kryesor dhe jo thelbi nëqoftëse ka një deficit demokratik në BE. Shumica e ligjërimeve dhe divergjencat midis studiuesve nuk janë rreth deficitit demokratik në vetvete, ato janë më tepër të lidhura me modelin e referimit të BE-së. Për të sjellë vetëm një shembull nga debati, Marovcsik dhe Zweifel pavarësisht se të dy argumentojnë se nuk ka një deficit demokratik në BE, kanë divergjenca rreth nivelit të analizës se si duhet konceptuar BE-ja. Sugjerimi këtu, është se duhet bërë kujdes në pranimin apo refuzimin e çdo argumenti të sjellë në debat pasi që ato janë kontekstuale në varësi të nivelit-të-analizës që studiuesit kanë zgjedhur. Pikë së pari, debati rreth deficitit demokratik duhet të evidentojë në mënyrë eksplicite dhe të qartë çfarë entiteti politik konsideron kur i referohet BE-së dhe modelin me të cilin e krahason atë. Mënyra sesi e përshkruajmë dhe konceptojmë BE-në dhe me çfarë e krahasojmë atë ndikon direkt në vlefshmërinë e argumenteve për ekzistencën e një deficiti demokratik apo jo në BE.

Sugjerime rreth asaj çka duhet të argumentojë debati mbi deficitin demokratik në rastin e BE-së.

Nëqoftëse duam të analizojmë nëse ka një deficit demokratik në BE apo jo, do të na duhet të saktësojmë një model (ideal) të demokracisë si dhe entitetin politik me të cilin mund të krahasojmë BE-në. Pikë së pari, një model ideal i demokracisë mungon dhe për më tepër edhe kriteret më minimale të një demokracie relative janë të debatueshme në varësi të mëshimit më shumë të argumenteve

konstitucionaliste apo social-kulturore. Së dyti, karakteri politik i BE-së mbetet i diskutueshëm, dhe ajo çka gjithë studiuesit kanë dhënë konsensus është se BE-ja minimalisht mund të konceptohet si një 'sistem politik'²³ prandaj edhe krahasimet për analogji duhet të bëhen në këtë nivel-analize. Divergjencat e debatit gjenden pikërisht në këto dy çështje, çfarë standarde për demokracinë dhe çfarë analogjie për një krahasim më të përshtatshëm më rastin e BE-së.

Që prej mes-viteve '90 kur Weiler dhe kolegët e tij përcaktuan 'versionin standard' të deficitit demokratik, shumë studiues të tjerë e rimorën atë në shqyrtim²⁴ dhe përmirësim (Føllesdal dhe Hix 2006) duke treguar edhe një herë se debati rreth deficitit demokratik të BE-së është ende në fazën e vendosjes së standardeve (Majone, 1998, f. 6), pra anën normative, duke lënë pas analizat empirike (përfshirë Zweifel 2002). Mungesa e analizave empirike përlligjet nga fakti se ne nuk mund të masim diçka nëse më parë nuk e dimë se çfarë është ajo të cilën duhet të matim.²⁵ Nga ana tjetër, lind pyetja nëse është e dobishme të vazhdojmë pafundësisht këtë debat ri-vlerësimi standardesh normative apo është më mirë që, siç Meny sugjeron, të kërkojmë një koncepti të ri demokracie post-kombëtare (2002, f 11)?

Para se të abandonojmë konceptin 'deficit demokratik' është e dobishme t'i rikthehemi dhe referohemi edhe një herë origjinës prej nga lindi termi, pra analizës së Marquand mbi funksionimin e institucioneve të BE-së (atëherë KE) dhe mangësi të komponentëve të tyre demokratike. Duke ditur që Bashkimi Europian është një entitet politik në 'lëvizje' duhet theksuar fakti se ai gjithnjë ka marrë masa për të përmirësuar mangësitë demokratike.²⁶ Vënia në dukje e mangësi apo hendekut dhe të pritshmërive apo kërkesave për përmirësim mund të jetë një debat më i dobishëm. Pra, në vend që të theksohet termi 'demokratik' është më mirë që të theksojmë termin 'deficit', i cili nënkupton 'diçka që kërkohet ose pritet'²⁷ të përmirësohet. Në këtë këndvështrim, 'deficit demokratik' në rastin e Bashkimit Europian konceptohet në një kontekst më të gjerë, si një term i cili vlerëson performancën e Bashkimit Europian dhe jo demokracinë. Kjo është një karakteristikë e përbashkët e debatit pasi të gjithë studiuesit presupozojnë ekzistencën e një 'mase' deficit si pjesë e argumenteve të tyre (Crombez, 2003, f. 103). Edhe ata studiues të cilët nuk pajtohen me idenë e një 'deficit demokratik' në Bashkimin Europian përsëri gjejnë problematika dhe flasin për një nevojë përmirësimi të status quo-së²⁸ qoftë nëpërmjet reformimit të institucioneve apo edhe duke sjellë më shumë integrim në komunitet. Prezantimi i debatit 'në gota është gjysmë plot apo gjysmë bosh' nuk e ndryshon thelbin e çështjes, atë të nevojës për përmirësim të BE-së.

Siç rezulton edhe nga paraqitja në këtë artikull, debati rreth deficitit demokratik në BE mbetet i hapur dhe pa një përgjigje definitive nëse mund të flasim për një deficit

(vijon në faqen 22)

Debati Intelktual mbi Deficitin Demokratik në Bashkimin European

(vijon nga faqja 21)

demokratik të BE-së. Gjithsesi ajo që ne mund të themi në këtë fazë, e cila është edhe një karakteristikë e përbashkët

e debatit, është nevoja për përmirësimin e institucioneve të BE-së dhe ndërtimit të një komuniteti European.

Dr. Dorian Jano*

* PhD, Universiteti i Milanos; MA, Universiteti i Bolonjës, Lektor i Studimeve Europiane, Universiteti Marin Barleti

- ¹ Ky artikull bazohet mbi një kërkim gjatë periudhës kur autori kryente doktoraturën dhe një version më i zgjeruar në anglisht gjendet i publikuar tek Jano, D. 2008 'Understanding the "EU democratic deficit": A two dimension concept on a three level-of-analysis', *Politikon: The IAPSS Journal of Political Science* 14(1): 61-74.
- ² Schmidt, V. 2009 'The EU and its Member States: From Bottom Up to Top Down', në D. Phinnemore and A. Warleigh-Lack (eds), *Reflections on European Integration. 50 Years of the Treaty of Rome*, Palgrave.
- ³ Mény, Y. 2003, 'De la démocratie en Europe: Old Concepts and New Challenges', *JCMS Journal of Common Market Studies* 41(1): 1-13.
- ⁴ Føllesdal, A & Hix S 2006, 'Why there is a Democratic Deficit in the European Union. A Response to Majone and Moravcsik', *JCMS* 44(3): 533-62, f. 534.
- ⁵ Bellamy, R 2006, 'Still in Deficit: Rights, Regulation and Democracy in the EU', *European Law Journal* 12(6): 725-42, f. 725.
- ⁶ Moravcsik in 2000 'Democracy and Constitutionalism in the European Union', *ECSA Review* 13(2), f. 2-7.
- ⁷ König, Th 2007, 'Divergence or convergence? From ever-growing to ever-slowng European legislative decision making', *European Journal of Political Research*, 46: 417-444, f. 422.
- ⁸ Crombez, Ch 2003, 'The democratic deficit in the European Union', *European Union Politics*, 4(1): 101-120, f. 115.
- ⁹ Sbragia cituar në Zweifel, Th 2002, '...Who is without sin cast the first stone: the EU's democratic deficit in comparison', *Journal of European Public Policy* 9(5): 812-40, f. 817
- ¹⁰ Tradicionalisht ka ekzistuar nevoja për të justifikuar në BE nëpërmjet institucioneve më demokratike. Moravcsik në 2000 'Democracy and Constitutionalism in the European Union', *ECSA Review* 13(2), f. 2-7.
- ¹¹ Majone në 2000 'Democracy and Constitutionalism in the European Union', *ECSA Review* 13(2), f. 2-7.
- ¹² shih për shembull Etzioni, A 2007, 'The Community Deficit', *JCMS* 45(1): 23-42.
- ¹³ Shih në Cohen, J & Sabel, Ch 2003, 'Sovereignty and Solidarity: EU and US', in *Governing Work and Welfare in a New Economy: European and American Experiments*, eds. J Zeitlin & D Trubek, Oxford University Press, Oxford, f. 703
- ¹⁴ Offe, C & Preuss, U 2006, 'The Problem of Legitimacy in the European Polity. Is Democratization the Answer?', *Constitutionalism Webpapers*, ConWEB No 6
- ¹⁵ Kohler-Koch, B & Rittberger, B 2006, 'Review Article: The "Governance Turn" in EU Studies', *JCMS*, 44(1):27-49, f. 35
- ¹⁶ Risse cituar Schmidt, në 2000 'Democracy and Constitutionalism in the European Union', *ECSA Review* 13(2), f. 2-7. 2004, f. 992
- ¹⁷ Moravcsik, në 2000 'Democracy and Constitutionalism in the European Union', *ECSA Review*, f. 361
- ¹⁸ Føllesdal, A. nodate, 'Citizenship and Political Rights in the European Union: Consensus and Questions'. Available at <http://www.ihs.ac.at/public_rel/kbericht/ak1/fo.html>
- ¹⁹ Moravcsik, në 2000 'Democracy and Constitutionalism in the European Union', *ECSA Review*, p. 361
- ²⁰ Chrysochoou, D 2002, 'Europe in the Republican Imagination', *Constitutionalism Web-Papers*, ConWEB No. 3, f. 1.
- ²¹ Gjithsesi Majone nuk e pranon BE-në si shtet por ai e përdor analogjinë për shkak krahasimi pasi vlerëson se akoma nuk ka kriteret normative të përshtatshme për karakterin *sui generis* të Komunitetit European (1998, f. 6).
- ²² Zielonka, J 2007, 'Plurilateral Governance in the Enlarged European Union', *JCMS* 45(1):187-209, f. 203.
- ²³ Shih: Hix, S. dhe Hoyland, B. (2011) *The Political System of the European Union*, London: Macmillan. Kapitulli 1.
- ²⁴ Majone, G 1998, 'Europe's "Democratic Deficit": The Question of Standards', *European Law Journal* 4(1): 5-28.
- ²⁵ Sartori, G 1970, 'Concept Misformation in Comparative Politics', *The American Political Science Review* 64(4): 1033-1053, f. 1038
- ²⁶ Eriksen, E 2006, 'Deliberation and the problem of democratic legitimacy in the EU: Are working agreements the most that can be expected?', *Arena Working Papers* 08, f. 20.
- ²⁷ Ky është një prej kuptimeve të termit 'deficit' në fjalorin Anglisht të Oxford-it.
- ²⁸ Autorët të cilët argumentojnë se nuk ka 'deficit demokratik' përsëri pranojnë faktin se ka ende probleme dhe ka nevojë për përmirësim. Për shembull Zweifel (2002, f. 812) pranon se 'ka akoma vend për përmirësimë ..., ndërsa për Crombez (2003, f. 117) 'deficiti demokratik është, në radhë të parë, një problem i mungesës së informacionit dhe delegimit të tepruar', deklarata të tilla përforcojnë gjithnjë e më shumë idenë e Meny se '... askush nuk mund ta mohojnë se ka një problem real' (2002, f. 11.) në BE.

KALENDARI

I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(11 qershor – 28 qershor 2012)

(vijon nga faqja 1)

- Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik (përgjegjës)
- Komisioni për Integrimin Europian
- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

2. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës së Kroacisë”.

- Komisioni për Ekonominë dhe Financat (përgjegjës)
- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Komisioni për Politikën e Jashtme

3. Projektligj “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

- Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik (përgjegjës)
- Komisioni për Integrimin Europian
- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
- Komisioni për Ekonominë dhe Financat

4. Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, të ndryshuar”.

- Komisioni për Ekonominë dhe Financat

5. Projektligj “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë”.

- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (përgjegjës)
- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
- Komisioni për Integrimin Europian

6. Projektligj “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Kombeve të Bashkuara për vendosjen e rregulloreve teknike globale për automjetet me rrota, pajisjet dhe pjesët që mund të instalohen ose të përdoren tek automjetet me rrota”.

- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë

dhe Mjedisin (përgjegjës)

- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Komisioni për Politikën e Jashtme

7. Projektligj “Për një ndryshim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

- Komisioni për Ekonominë dhe Financat

8. Projektligj “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”.

- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin (përgjegjës)
- Komisioni për Integrimin Europian

9. Projektligj “Për shfuqizimin e ligjit nr. 9509, datë 3.4.2006 “Për shpalljen e Moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”.

- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (përgjegjës)
- Komisioni për Sigurinë Kombëtare

- SEANCË PLENARE -

E enjte, datë 14 qershor 2012, ora 10.00

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare.

2. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës së Kroacisë”.

· Shprehet Komisioni për Ekonominë dhe Financat (përgjegjës)

· relator:

· Shprehet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

· relator:

· Shprehet Komisioni për Politikën e Jashtme.

· relator:

· Pyetje

· Diskutime

· Koha e debatit

Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës “Anëtarit të Këshillit të Ministrave i jepet fjala sa herë që e kërkon”.

· Pas përfundimit të diskutimeve:

(në emër të grupit parlamentar të LSI, z. Lefter Koka,

(vijon në faqen 24)

KALENDARI

I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(11 qershor – 28 qershor 2012)

(vijon nga faqja 23)

Kryetar grupi) (në emër të grupit parlamentar të PS, z. Gramoz Ruçi, Kryetar grupi) (në emër të grupit parlamentar të PD, z. Astrit Patozi, Kryetar grupi)

- Koha e votimit

3. Projektligj “Për shfuqizimin e ligjit nr. 9509, datë 3.4.2006 “Për shpalljen e Moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”.

- Shprehet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (përgjegjës)

- relator:
- Shprehet Komisioni për Sigurinë
- relator: Osman Metalla
- Pyetje
- Diskutime
- Koha e debatit

Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës “Anëtarit të Këshillit të Ministrave i jepet fjala sa herë që e kërkon”.

Pas përfundimit të diskutimeve:

(në emër të grupit parlamentar të LSI, z. Lefter Koka, Kryetar grupi)

(në emër të grupit parlamentar të PS, z. Gramoz Ruçi, Kryetar grupi)

(në emër të grupit parlamentar të PD, z. Astrit Patozi, Kryetar grupi)

- Koha e votimit

4. Projektrezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2011”.

- I pranishëm Avokati i Popullit
- Shprehet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

- relator:
- Koha e votimit

5. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (60’).

- SEANCË PLENARE -

E enjte, datë 21 qershor 2012, ora 10.00

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare.

2. Projektligj “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”.

· Shprehet Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

- relator:
- Shprehet komisioni për Integrimin European
- relator:

- Pyetje
- Diskutime
- Koha e debatit

Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës “Anëtarit të Këshillit të Ministrave i jepet fjala sa herë që e kërkon”.

Pas përfundimit të diskutimeve:

(në emër të grupit parlamentar të LSI, z. Lefter Koka, Kryetar grupi)

(në emër të grupit parlamentar të PS, z. Gramoz Ruçi, Kryetar grupi)

(në emër të grupit parlamentar të PD, z. Astrit Patozi, Kryetar grupi)

- Koha e votimit

3. Projektligj “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

- Shprehet Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik (përgjegjës)

· relator: *Ismail Hoxha dhe Paulina Hoxha*

(dhënie mendimi)

· relator: *Marko Bello*

· Shprehet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (dhënie mendimi)

· relator:

· Shprehet Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë (dhënie mendimi)

· relator:

· Shprehet Komisioni për Ekonominë dhe Financat (dhënie mendimi)

· relator: *Selami Xhepa*

- Pyetje
- Diskutime
- Koha e debatit

Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës “Anëtarit të Këshillit të Ministrave i jepet fjala sa herë që e kërkon”.

Pas përfundimit të diskutimeve:

(në emër të grupit parlamentar të LSI, z. Lefter Koka, Kryetar grupi)

(në emër të grupit parlamentar të PS, z. Gramoz Ruçi, Kryetar grupi)

(në emër të grupit parlamentar të PD, z. Astrit Patozi, Kryetar grupi)

- Koha e votimit

4. Projektrezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe

(vijon në faqen 25)

KALENDAR I

I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(11 qershor – 28 qershor 2012)

(vijon nga faqja 24)

Kontrollit të Pasurive”për vitin 2011”.

- I pranishëm Inspektori i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

- Shprehet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

- relator:
- Koha e votimit

5. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (60’).

- SEANCË PLENARE -

E enjte, datë 28 qershor 2012, ora 10.00

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare.

2. Miratimi i Kalendarit 3-javor (2 korrik - 26 korrik 2012).

3. Projektligj “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Kombeve të Bashkuara për vendosjen e rregulloreve teknike globale për automjetet me rrota, pajisjet dhe pjesët që mund të instalohen ose të përdoren tek automjetet me rrota”.

- Shprehet Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin(*përgjegjës*)

- relator:
- Shprehet komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

- relator:
- Shprehet Komisioni për Politikën e Jashtme.
- relator:
- Pyetje
- Diskutime
- Koha e debatit

Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës “Anëtarit të Këshillit të Ministrave i jepet fjala sa herë që e kërkon”.

- Pas përfundimit të diskutimeve:

(në emër të grupit parlamentar të LSI, z. Lefter Koka, Kryetar grupi)

(në emër të grupit parlamentar të PS, z. Gramoz Ruçi, Kryetar grupi)

(në emër të grupit parlamentar të PD, z. Astrit Patozi, Kryetar grupi)

- Koha e votimit

4. Projektligj “Për një ndryshim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

- Shprehet Komisioni për Ekonominë dhe Financat (*përgjegjës*)

- relator:
- Pyetje
- Diskutime

- Koha e debatit

Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës “Anëtarit të Këshillit të Ministrave i jepet fjala sa herë që e kërkon”.

Pas përfundimit të diskutimeve:

(në emër të grupit parlamentar të LSI, z. Lefter Koka, Kryetar grupi)

(në emër të grupit parlamentar të PS, z. Gramoz Ruçi, Kryetar grupi)

(në emër të grupit parlamentar të PD, z. Astrit Patozi, Kryetar grupi)

- Koha e votimit

5. Projektligj “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë”.

- Shprehet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (*përgjegjës*)

- relator:

- Shprehet Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

- relator:

- Shprehet Komisioni për Integrimin Europian

- relator:

- Pyetje

- Diskutime

- Koha e debatit

Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës “Anëtarit të Këshillit të Ministrave i jepet fjala sa herë që e kërkon”.

Pas përfundimit të diskutimeve:

(në emër të grupit parlamentar të LSI, z. Lefter Koka, Kryetar grupi)

(në emër të grupit parlamentar të PS, z. Gramoz Ruçi, Kryetar grupi)

(në emër të grupit parlamentar të PD, z. Astrit Patozi, Kryetar grupi)

- Koha e votimit

6. Projektrezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011”.

- I pranishëm Komisionerja për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- Shprehet komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

- relator:

- Koha e votimit

7. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (60’).